



VEPRA 11

Sami Frashëri

GJUHA

*(Botuar për herë të parë
në Stamboll më 1886)*

Shënim

Këtë vepër e botojmë me numrin rendor 11 për të ruajtur vazhdimsinë e veprave të Sami Frashërit të botuara në Shtëpinë Botuese “Rilindja” në Prishtinë.

E falënderojmë përzemërsisht Redaksinë e botimeve të Rilindjes për pëlqimin e dhënë dhe për mirëkuptim.

Nga botuesi

Njohja e gjithë atyre gjuhëve të vjetra e të reja, të Lindjes e të Perëndimit, pra, të turqishtes, arabishtes e persishtes, nga njëra anë, dhe të greqishtes së vjetër e të resë, latinishtes, frengjishtes, italishtes dhe, natyrisht, të shqipes, si gjuhë të nënës, nga ana tjetër, i mundësuan Sami Frashërit, këtij dijetari të madh shqiptar të shekullit 19, të lërë pas vetes një veprimtari shumë të pasur e shumë të gjithanshme krijuese e shkencore; të lërë pas vetes mbi gjashtëdhjetë vepra: letrare, didaktike, islamologjike, dialektologjike, enciklopedike, leksikologjike, filologjike etj.¹

Sa njohuri të thella ka pasur Samiu për gjuhët, kjo shihet në gjithë veprimtarinë e tij, e sidomos të fjalorët njëgjuhësorë dhe dygjuhësorë të hartuar nga ana e tij: *te Fjalori i gjuhës turke* me 1575 faqe, me afër 45 mijë fjalë; *te Fjalori frengjisht-turqisht* me afër 50 mijë fjalë; *te Fjalori turqisht-frengjisht* me afër 35 mijë fjalë; *te Fjalori arabisht-turqisht* etj., të cilët i ka punuar me një metodologji shkencore bashkëkohore. Po marrim si shembull vetëm Fjalorin e gjuhës turke: shënon aty etimologjinë e fjalëve, llojin e fjalëve (emër, mbiemër, folje etj.), kuptimet e fjalëve sipas rëndësisë së tyre, frazeologjizmat, kuptimet figurative; përdor shenjat diakritike për shkronjat arabe-osmane, të cilat në gjuhën turke kanë mundësi të lexohen në mënyra të ndryshme, i vokalizon fjalët për të dalluar homonimet etj., fjalor ky që edhe sot e kësaj dite nuk e ka humbur fare vlerën e tij në fushën e turkologjisë dhe të orientalistikës botërore, por përkundrazi. Kur shihen këto vepra leksikologjike, që janë vetëm një pjesë në krahasim me veprimtarinë e përgjithshme të tij, nuk ka asnjë arsye të mos themi se jemi para një njeriu me kulturë shumë të madhe gjuhësore, para një poliglotti të vërtetë, para një njeriu që, siç do të thonin të tjerët, nuk diti të lodhet; që është një faqe e historisë; që bëri aq shumë sa që akademitë me 40-50 anëtarë nuk do ta bënin vite me radhë etj.

I mburjtur nga një kulturë të gjerë gjuhësore, Samiu ishte në situatë të favorshme të përcjellë të arriturat e gjuhësisë në Evropë dhe më gjerë, pikërisht në kohën kur ajo (gjuhësia) filloi të përparonte me një ritëm të përshpejtuar. Pikëpamjet e tij për gjuhën; për rëndësinë e njohjes dhe mësimin të gjuhëve të huaja; për përdorimin e drejtë të termit lingistikë; për lidhjet e ngushta të gjuhësisë me gjeologjinë dhe antropologjinë; për shfaqjen dhe zanafillën e gjuhës; për dallimin në mes zërit dhe tingullit; për përcaktimin e emrave dhe shfaqjen e fjalëve; për ndarjen e gjuhëve nga aspekti tipologjik (njërrokëshe, përngjitëse dhe eptimore) dhe për përparimin shkallë-shkallë të tyre; për grupimin, degëzimin dhe afritë e gjuhëve, duke marrë shembuj përkatës (edhe nga gjuha shqipe), si dhe shumë e shumë çështje të tjera, Samiu do t'i pasqyrojë në veprën e tij filologjike *Lisân* "Gjuha", e cila, për arsye të ndryshme, ka qenë e panjohur deri më tash për opinionin shqiptar. Dhe ja, këtë vepër të rëndësishme të Sami Frashërit tani po ia ofrojmë lexuesit tonë në tërësi në gjuhën shqipe, me shpresë se kemi kryer dy obligime: ndaj shkencës dhe lexuesit shqiptar, nga njëra anë dhe, ndaj Samiut, që gjithë jetën e vet ia kushtoi diturisë, nga ana tjetër.

¹. Shih gjerësisht për këtë: Zymber Hasan Baku, *Sami Frashëri, Vepra 8*, Prishtinë, 1984; dhe Agâh Sırrı Levend, *Şemsettin Sami*, Ankara, 1969.

Vepra *Lisân* “Gjuha” është botuar për herë të parë në vitin 1303h., që përkon me vitin 1886², në shtypshkronjën “Mihran”, në Stamboll; i ka 128 faqe, me përmasën 10/15 cm; është shkruar në gjuhën turke-osmane; mban shënimin vëllimi 1 dhe numrin 27. Numri 27 shënon serinë e veprave të botuara në kuadër të botimeve “Biblioteka e xhepit”, ku janë botuar gjithsej 32 vepra, prej tyre, njëmbëdhjetë janë shkruar nga Samiu, e nëse mbajmë parasysh se dy nga ato janë botuar: njëra në 4 pjesë dhe tjetra në 2 pjesë, atëherë numri i veprave të Samiut aty do të jetë pesëmbëdhjetë. “Biblioteka e xhepit” hapet me veprën *Medeniyyet-i Islâmiyye* “Qytetërimi islam”³, që mban numrin rendor 1, për të vazhduar dhe me vprat e tjera: *Esâtir* (nr.2) “Mitologjitë”, *Kadınlar* (nr.3) “Gratë”⁴, *Gök* (nr.4) “Qielli”, *Yer* (nr.5) “Toka”, *İnsân* (nr.10) “Njeriu”, *Emsâl* (nr.11-14) “Fjalë të urta”⁵, *Letâif* (nr.17-18) “Tregime zbavitëse”, *Yine İnsân* (nr.26) “Përsëri njeriu”, *Lisân* (nr.27) “Gjuha” dhe mbyllet po ashtu me veprën e Samiut *Usûl-i Tenkât ve Tertîp* (nr. 32) “Mënyra e pikësimit dhe e radhitjes”. Nga veprat e përmendura këtu, nga veprat me tema të ndryshme: islamologjike, gjeologjike, antropologjike, astronomike, filologjike etj., shihet erudicioni i gjerë i Samiut, por dhe energjia e madhe e punës, sidomos kur kemi parasysh se shtatë veprat e para të kësaj serie (shih radhitjen më lart) Samiu i nxori në dritë vetëm brenda një viti, në vitin 1879⁶. Çdo koment lidhur me këtë është i tepërt.

Vepra “Gjuha”, siç u përmend edhe më lart, ndër të tjera mban edhe shënimin vëllimi 1, që s’do mend, vetvetiu nënkupton edhe vëllimin 2. Meqenëse kjo çështje ka mbetur paksa e paqartë, meriton t’i themi dy-tri fjalë. Është shumë e vërtetë se Samiu kishte menduar të shkruante edhe një vepër tjetër për gjuhën. Këtë mendim ai do ta shprehë në fund të kësaj vepre, ku thotë: “Harmonia e bashkëtingëlloreve dhe harmonia e zenoreve, që u trajtua dhe u ndriçua te gjuhët bantu dhe që do të trajtohet e do të ndriçohet te gjuhët turanike...”. Por, a ka shkruar Samiu një vepër tjetër të këtillë që do të mbante shënimin vëllimi 2 ose ndonjë vepër tjetër me titull të përafërt, që do ta plotësonte të parën, kjo akoma mbetet e panjohur. Profesor H. Kaleshi, në punimin e tij tashmë të njohur “*Sami Frashëri në letërsinë dhe në filologjinë turke*”, të botuar në Gjurmime Albanologjike I, Prishtinë, 1968, f. 66-67, kur flet për veprën *Lisân* “Gjuha” ndër të tjera shkruan (po e japim pa ndryshime gjuhësore): “Turkologu ma i madh Deny e vlerëson shumë naltë këtë vepër të Samiut...”, për të thënë më poshtë se “ai ka shkruar edhe një vepër tjetër me titull *Yine Lisan* (Përsëri gjuha), e cila kurrkund nuk përmendet me përjashtim të J. Deny, simbas të cilit edhe e citojmë. Edhe këtë vepër J.Deny e çmon nalt dhe i ven një yll përpara. Por, çka asht përmbajtja e kësaj vepre –vazhdon Kaleshi – nuk kam ide se kurrkund nuk kam mujtë me e gjetë as veprën as ndonji shënim mbi te”. Këto të dhëna, megjithatë, duhet pranuar me rezervë; mund të jetë këtu ndonjë lëshim ose nga ana e Denyt ose nga ana e Kaleshit, sepse vepra që përmendet këtu *Yine Lisan* (Përsëri gjuha), përputhet plotësisht me shënimet e veprës ekzistuese *Yine İnsân* (Përsëri njeriu), në të cilën, ç’është e vërteta Samiu përmend disa aspekte gjuhësore, sidomos terminologjinë-termin linguistikë (sh. këtu f.21). Botimin e pjesës së dytë të veprës *Lisân* “Gjuha”, e vë në dyshim edhe dijetari i njohur turk, Levendi, i cili për të hartuar monografinë për Sami Frashërin, përveç hulumtimit të materialit nëpër biblioteka, arkiva etj., kishte shfrytëzuar, siç thotë ai, edhe materialin e lënë nga Samiu, që ruhej nga nipi i tij, z. Emin Ezeri. Megjithatë, le të shpresojmë se hulumtimet e mëtejme do të na japin rezultate të tjera.

2. Në vitin 1997, në Ankara, është botuar edhe me shkrimin e tanishëm turk. Këtë e përgatiti Ismail Doğan.

3. Është botuar në gjuhën shqipe: Sami Frashëri, *Vepra 10*, Prishtinë; e përktheu Mehdi Polisi.

4. Sami Frashëri, *Gratë*, Shkodër, 1973; e përktheu Hamdi Bushati.

5. Është përkthyer pjesërisht në gjuhën shqipe, shih: Sami Frashëri, *Vepra 3*, Prishtinë, 1978.

6. Në këtë vit Samiu kishte botuar dhe: *Alfabetare e gjuhës shqip*; revisten *Aile* “Familja” dhe punime të tjera.

Sa i përket veprës “*Gjuha*” (Lisân), që mban shënimin vëllimi 1, e cila tashmë është pronë e lexuesit shqiptar, mund të them se, megjithëse ka kaluar një kohë mjaft e gjatë nga koha e botimit, pra mbi 120 vjet dhe, megjithëse gjuhësia ka shënuar përparime jashtëzakonisht të mëdha gjatë fundshekullit të nëntëmbëdhjetë, e sidomos gjatë shekullit njëzet, domethënë, ka shkuar me hapa gjigantë, e jo duke hedhur nga një hap në çdo shekull, siç do të shprehej Samiu, jam thellë i bindur se, megjithatë, kjo vepër do ta ketë vendin dhe peshën e vet në mesin e literaturës gjuhësore, do të jetë një ndihmesë për të gjithë ata që merren me gjuhësi. Për vlerësime të mëtejme t’ia lëmë fjalën lexuesit.

Shfrytëzoj rastin të falënderoj recenzentët Dr. Ismail Ahmedin dhe Dr. Ragip Mulakun për kontributin e tyre. Falënderoj njëkohësisht edhe z. Adnan Ismailin që ma siguroi origjinalin e veprës.

Prishtinë, 1. 03. 2001
Dr. Mehdi POLISI

1
Ç'është gjuha?

Gjuha, s'ka dyshim, është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut. Në mesin e mijëra llojeve të shtazëve, vetëm njeriu është zotëruar i gjuhës. Në të vërtetë, sa i përket të shprehurit të qëllimit, që ka për qëllim gjuhën, edhe kafshët e ndryshme kanë mundësi ta shprehin qëllimin e tyre, varësisht nga shkalla e nevojës, kapaciteti dhe nga aftësia e të kuptuarit të tyre, si dhe brenda mundësive dhe përmasave që ua lejon trupi dhe organizmi i tyre. E sa i përket të folurit, që i referohet po ashtu gjuhës, domethënë, të folurit, që formohet nga tinguj (zëra) të ndryshëm, shihet se këtë mund ta realizojnë edhe shpezët si, për shembull, papagalli. Për shkak të këtij mendimi, ata që merren me gjuhën e kafshëve e përshkruan dhe e përcaktuan njeriun si „kafshë që flet”, prandaj, ata i qenë nënshtruar kritikës së natyralistëve. Megjithatë, duke mbajtur parasysh të dyja mundësitë e posapërmendura - të flasësh gjuhën që është formuar nga tinguj (zëra) të ndryshëm për të shprehur qëllimin dhe, të flasësh fjalë të ndryshme, sipas nevojës- nëse shprehet me shenja gjuhësore, do të kuptohet se në përshkrimin e atyre që merren me gjuhën e kafshëve nuk ka madje shumë gabime. Po ashtu, do të kuptohet se ai që me të vërtetë flet, është vetëm njeriu; dhe se gjuha është veçori vetëm e racës (llojit) njerëzore.

Historia e natyrës e vendos njeriun në mesin e shumë kafshëve. Edhe anatomia krahasimtare e afron njeriun me disa kafshë ose ato kafshë i afron me njeriun. Por, megjithatë, gjuha është mjeti që i përgënjeshtrohet të gjitha këto afrime. Ndërmjet njeriut dhe kafshëve të tjera ngrihet një mur i madh. Për shembull, nga njëra anë, majmunët, le të ecin me dy këmbë sa të duan, le të tregojnë shenja të zgjuarsisë sa të duan, le të na përngjajnë neve sa të duan dhe, nga ana tjetër, bushmanët e Afrikës, negritasit dhe papuasit e Australisë, fuxhiasit e Amerikës Jugore¹. le të shëtisin lakuriq, le të ushqehen me ujë, me insekte, me barëra dhe me ngordhësira, le të jetojnë si kafshë sa të duan; anatomia krahasimtare le të tregojë sa të dojë dallimin në mes këtyre dhe nesh dhe, le të tregojë sa të dojë ngjashmërinë në mes majmunëve dhe këtyre popujve, prapëseprapë nëpërmjet gjuhës do të kuptohet shumë qartë se këta popuj primitivë, me gjithë primitivizmin e tyre, janë njerëz, kurse majmunët, me gjithë zgjuarsinë e tyre, megjithatë, janë kafshë. Në të vërtetë, as mund të gjendet farë e racës njerëzore që nuk ka aftësi të flasë, e as lloj të kafshëve që flet një gjuhë, që me të drejtë do të quhej gjuhë.

Tingujt (zërat), që përdoren për të shprehur qëllimin dhe që formojnë gjuhë të ndryshme, nuk nyjëtohen vetëm me gjuhë. Edhe fyti, edhe vrimat e hundës, edhe dhëmbët, edhe buzët edhe hunda janë organe të të folurit. Sado që shihet se gjuha nuk ka asnjë funksion në nyjëtimin e fjalëve, si, për shembull, “ai”, “ky”, dhe “kush”² me të vërtetë, roli i gjuhës në këtë proces është më i madh, prandaj fjala që i përket, që i

¹. Shih veprën time *Yine Insân*, nr. 26, Cep Küttüphanesi. (shën. i S.Frashërit).

². Këta shembuj janë dhënë në gjuhën turke. Unë i kam përkthyer dhe i kam përshtatur në gjuhën shqipe. Kështu do të veproj edhe më tutje, por aty ku e kam parë të nevojshme i kam lënë edhe në atë gjuhë. (M. P.).

referohet këtij organi, gati te çdo popull dhe te çdo komb përdoret edhe për të folurit. Kështu, fjalët, si: *dil*, *lisân* dhe *zebân*³ përdoren për të shprehur edhe këtë kuptim.

Megjithatë, termi *gjuhë* nuk është i kufizuar me fjalët e formuara nga tingujt (zërat), që shqiptohen vetëm me gojë dhe me gjuhë. Ashtu si natyralistët, që e quajnë *gjuhë* dhe *gjuhë imituese* edhe të shprehurit e qëllimit, që realizohet me shenja të ndryshme, ne, ndërkaq, edhe asaj që shprehet me shkrim i themi *gjuhë*. Vërtet, shkrimet që përdoren te ne, përshkruajnë tingujt (zërat) që i përdorim për të folurit, por, të shprehurit e qëllimit me shkrim, që i themi gjuhë, sado që mund të shfaqet në një kuptim tjetër, të ndryshëm, atë, pasi e kanë përdorur popujt e lashtë si, egjiptasit dhe, pasi kinezët e përdorin akoma në shkrimet e tyre, merret vesh se ky kuptim nuk ka mundësi të ndryshojë, sepse këto shkrime nuk përshkruajnë tingujt (zërat), por përshkruajnë gjësendet që synohen. Në të vërtetë, sado që, për shembull, në shkrimin kinez, nuk shihet se forma që përshkruan fjalën *diell*, i ngjan diellit; ajo formë, nuk është gjë tjetër përveç ilustrimit të një dielli të thjeshtë dhe të madh, që është përdorur në kohëra të lashta, por, duke u shkruar vazhdimisht, ka ndryshuar shpejt dhe ka ardhur në atë gjendje sikur lidhet me rregullat bukurshkruese të kaligrafisë. Dhe të gjitha format e tjera janë të këtilla.

Në këtë gjendje mund të besojmë se çdo lloj mjeti që përdoret për të shprehur qëllimin, duhet t'i thuhet gjuhë. Për shkak të besimit tonë që kemi për këtë, gjuha nuk është mjet i veçantë vetëm për njeriun. Mund të mendohet se pranojmë edhe pjesëmarrjen e shumë kafshëve të tjera në këtë mjet, por, idetë dhe mendimet tona në këtë temë, megjithatë, do t'i lëmë në një pjesë tjetër të veçantë. Këtu pikërisht do të kënaqemi me ritheksimin se gjëja që i thuhet gjuhë e plotë, e përsosur dhe e vërtetë, është veçori vetëm për gjininë njerëzore.

³. Të tria këto fjalë të nënvizuara kanë kuptimin "gjuhë", që shprehin edhe organin e të folurit edhe vetë të folurit. E para është me prejardhje turke, e dyta, arabe dhe e treta, persiane.(M. P.).

Vetmia dhe izolimi që i shohim sot vetëm ndër popujt primitivë, në kohëra të lashta kanë ekzistuar edhe te popujt e qytetëruar. Në kohëra të lashta, në mes popujve dhe kombeve sigurisht se kanë ndodhur luftëra dhe grindje më shumë se në kohën e tanishme; ata që kanë ngadhjyer i kanë mbajtur nën robëri dhe nën pushtetin e tyre të shtypurit; i kanë shpërngulur ose i kanë vrarë dhe vendet e tyre i kanë pushtuar ose, duke u marrë vesh me të shtypurit i kanë futur ata në gjirin e një populli të madh. Raste të këtilla ndodhnin shpeshherë, por, megjithatë, nuk kishte bashkësi dhe marrëdhënie në mes kombeve dhe popujve. E kam të qartë se në mes këtyre dy pohimeve tona do të ketë kundërthënie e mospajtime, por, mendoj se që të dyja janë të drejta dhe jam thellë i bindur se këto kundërthënie ekzistojnë vetëm kur shikohen sipërfaqësisht dhe aty nuk ka kurrëgjë të vërtetë.

Është e vërtetë se, përveç lidhjeve e marrëdhënieve që i përmendëm më sipër, edhe marrëdhëniet tregtare mes popujve nuk ishin krejtësisht të plota. Megjithatë, nuk binte interesimi i një populli për të mësuar gjuhën e popullit tjetër, që gjendej në fqinjësi me të. Çdo komb dhe çdo popull, duke e konsideruar veten të shenjtë, e kishte bërë shprehi që fqinjët e vet t'i shohë me urrejtje dhe neveritje. Izraelitët, duke e parë veten si një popull të zgjedhur dhe të dashur të Zotit, popujt e tjerë të botës i shihnin si pabesimtarë dhe të mallkuar. Madje grekët, të cilët ishin më të qytetëruarit e popujve të lashtë, të gjithë të tjerët jogrekë, i nënçmonin dhe i quanin si barbarë, domethënë të egër, primitivë. Kinezët, të cilët deri sot kanë mbetur në gjendjen e mëparme dhe shumica e popujve të Afrikës dhe të Amerikës, që gjenden në gjendje primitive, emrin njeri e kanë kufizuar vetëm për vetvete dhe veten e konsiderojnë të veçantë, kurse popujt e tjerë, që i kanë fqinjë, i quajnë me emrat, si: *i egër, qen, derr, ujk*. Duke i parë ata si të tillë, i urrejnë dhe neveriten, madje, nga njerëzit që mund të jenë më të mirë se ata.

Një popull dhe një komb, që ka mendim dhe kriter të këtyllë mbi fqinjët e vet, e humb interesimin për të mësuar gjuhën e tyre. Dhe, sidomos, duke i menduar ata madje të veçantë nga prejardhja e tyre, a mund të paramendohet e të shpresohet përpjekja e tyre për të kërkuar, për të hulumtuar dhe për të mësuar gjuhët e tyre, lidhjet e ngjashmëritë që janë mes tyre?

Në të vërtetë, të vjetrit nuk dinin se si mësohet gjuha e huaj, se si zgjerohet njohuria mbi gjuhët e huaja ose si kthjellohet e ndriçohet mendja. Historianët e vjetër grekë, sado që bënin fjalë për kombet dhe për popujt më të njohur të kohës së tyre, ata nuk jepnin asnjë njohuri për gjuhët e tyre. Edhe ata, që kishin udhëtuar nëpër Azi dhe Egjipt, si për shembull, Herodoti dhe Platoni, nuk kanë lënë të dhëna për gjuhët e vendeve që i kishin shëtitur dhe, për sa merret vesh, janë endur pa i kuptuar gjuhët e atyre vendeve.

Megjithatë, njeriu, derisa nuk mëson një gjuhë të huaj, ai edhe rregullat dhe imtësitë e gjuhës së vet nuk do të mund t'i dallojë lehtësisht, prandaj, popujt e lashtë, të cilët nuk i regjistruan dhe nuk i shënuan rregullat e gjuhëve të tyre, natyrisht, nuk dinin se ç'është

ajo të merresh me njohjen dhe me studimin e gjuhëve. Rregullat e gjuhës greke, pas rënies së qytetërimit të lashtë grek, janë regjistruar në Aleksandri nga ana e maqedonasve të lashtë, të cilët, duke jetuar me grekët, qenë qytetëruar me gjuhën e tyre. Ndërkaq, rregullat e gjuhës arabe ishin regjistruar nga asirianët (sirianët) dhe iranianët, pasi këta kishin hyrë në gjirin e qytetërimit arab-islam. Në Perëndim, që nga koha e romakëve e deri në fund të periudhës së tyre, mësoheshin greqishtja e latinishtja, kurse në Lindje, arabishtja, persishtja dhe turqishtja dhe kështu merreshin me rregullat e këtyre gjuhëve. Megjithatë, për lidhjet dhe marrëdhëniet në mes gjuhëve nuk është shfaqur ndonjë mendim i drejtë. Në Evropë, për shkak të besimit fetar, kanë besuar se të gjitha gjuhët kanë prejardhje të përbashkët nga gjuha ebreje, por kur kjo shihet me sy kritik, atëherë thelbi i të gjitha këtyre dhe i kësaj gjuhe, del se ata janë munduar kot të gjejnë lidhje dhe marrëdhënie mes gjuhëve evropiane dhe gjuhës ebreje. Ndër muslimanët ndërkaq, ka mbizotëruar një mendim i tillë për gjuhën asiriane(siriane). Edhe pse ky mendim, gjykuar sipas gjuhës arabe dhe persiane është deridiku i drejtë, sepse gjenden disa fjalë që e dëshmojnë këtë, megjithëkëtë turqishtja ishte e mjaftueshme për ta përgënjeshtuar e për ta hedhur poshtë këtë mendim.

Në ato kohë, ashtu siç kishin përparuar mjaft rregullat e gjuhëve letrare dhe posaçërisht rregullat e gjuhës ebreje, greke dhe latine, në këto gjuhë merreshin edhe me etimologji, por, siç dihet, etimologjia, duke qenë degë e gjuhësisë që ndriçon lidhjet dhe marrëdhëniet që ekzistojnë në mes vetë fjalëve të një gjuhe, për lidhjet e përbashkëta në mes gjuhëve të ndryshme akoma nuk ka mundur të shfaqet haptas asnjë mendim dhe asnjë dëshmi.

Mënyra e ndarjes së gjuhëve në lloje e në grupe; në nëngrupe e në degë; mënyra e klasifikimit të gjuhëve të popujve dhe kombeve dhe pastaj, njohuritë dhe rezultatet e drejta shkencore për shfaqjen e gjuhës dhe për mënyrën e formimit të saj, janë zbulime të kohës së re. Këto të dhëna kanë formuar një shkencë të veçantë që nga gjysma e shekullit (gjysma e shekullit 19-M.P.).

Ashtu si gjeologjia dhe antropologjia, edhe gjuhësia, që është një ndër arritjet e fundit të kohës sonë, duke u gjendur në lidhje të ngushtë me këto dy shkencë, e sidomos me antropologjinë, vazhdoi të përparojë e të përhapet bashkë me to. Në gjuhët evropiane është emërtuar **Linguistique** (linguistikë), kurse unë, siç e kam shpjeguar edhe në një vepër tjetër⁴ e pashë të arsyeshme e të përshtatshme ta përkthej me termin **ilmu-l-lisân**⁵.

Termi i lartpërmendur (linguistikë) – që është shfaqur në rregullat e gjuhës greke nga përshtatja e një fjale latine – u kundërshtua nga disa dijetarë evropianë. Ata që kishin preferuar që në vend të tij të pranohen termat, si: La science du langage ose La philologie comparée ishin të shumtë, veçanërisht, dijetarët gjermanë dhe anglezë mohuan ta pranojnë këtë “termin e gabueshëm” të francezëve, por, meqë ky term, është i thjeshtë, i qartë dhe i përshtatshëm, fitoi ndaj atij të gabueshmit, dhe gjeti shtrirje më të madhe.

Gjuhësia nuk është nga shkencat që përparojnë duke hedhur nga një hap në çdo shekull, sikurse matematika, filozofia dhe kimia, por vazhdon të përparojë me hapa gjigantë dhe të përherëshëm që kur zuri të shfaqet. Kështu, për gjysmë shekulli ka shënuar përparime shumë të mëdha dhe këtë vazhdon ta bëjë ditë për ditë. Antropologjia dhe gjuhësia, që janë krijuar pas gjeologjisë, kanë hapur një faqe të re në historinë e njerëzimit. Kjo shkencë e re, duke e shembur godinën e vjetër të historisë, i ka vënë themelin një godine të re, të mbështetur në fakte dhe në argumente. Historia njerëzore s’është krijuar tashmë nga disa përralla të mbinatyrshme të sajuara nga fjalët e paargumentuara, as nga disa pushtues të botës (madje edhe të dyshimtë), e as nga ngjarjet e trilluara të disa heronjve të pavërtetë. Është e domosdoshme të bëhet fjalë për historinë njerëzore, për qenien dhe racën e njeriut në përgjithësi dhe për gjendjen e natyrshme dhe për sjelljet e përgjithshme të kombeve dhe të popujve në veçanti. Dhe kjo ka të bëjë me antropologjinë dhe gjuhësinë, që janë formuar në bazë të rregullave të gjeologjisë. Këto shkencë shënuan përparime shumë të mëdha për një kohë të shkurtër. Nëse merret parasysh niveli i përparimit të tyre, mund të fitohet përshtypja se në çfarë shkalle do të arrijnë për një kohë të shkurtër.

Gjendja e tanishme e tyre mund të shihet si gjendja e fëmijës. Arritjet e tyre të mëtejme do të nxjerrin në shesh shumë të vërteta dhe do të shërbejnë për të zbuluar fshehtësitë e natyrës dhe të krijimit të saj. Në gjendjen e tanishme këto nuk dëshmojnë rezultate të plota. Sado që është e nevojshme dhe e domosdoshme të hyhet në disa hipoteza, sepse edhe hipotezat, duke mos u krijuar vetëm nga fantazitë, i përshtaten shkencës dhe mbështeten në krahasime, prandaj, zbulimet e fundit i përforcojnë dhe i argumentojnë

⁴ *Yine Insân*, nr. 26, Cep Kütüphanesi (S. Frashëri).

⁵ Është formim i arabishtes, që do të thotë “shkencë mbi gjuhën/gjuhësi”. Si duket Samiu është i pari që e ka vënë këtë term në qarkullim në Turqinë Osmane (M. P.).

shumë hipoteza të vjetra, sidomos, kur nga këto përftohet një përmbajtje shkencore e veçantë.

Thënë shkurt, edhe gjuhësia, (meqë është e rëndësishme sa antropologjia), duke hyrë në mesin e shkencave natyrore më të rëndësishme shqyrtohet në mënyrë të mjaftueshme nga natyralistët në tërë Evropën dhe, sidomos në Gjermani, në Angli dhe në Francë, ku u ngritën dijetarë që u morën në mënyrë të vazhdueshme vetëm me këtë shkencë. Ajo që i shërbeu më së shumti përparimit të kësaj shkence, është dëshira për të mësuar më tepër gjuhët që fliten anekënd rruzullit tokësor. Ashtu siç mësohej kaherë gjuha greke dhe latine në Evropë, po ashtu në shtetet e Evropës njihen dhe mësohen vazhdimisht edhe gjuhët e reja. Sa i përket ebraishtes, asirianishtes, arabishtes, indishtes dhe kinezishtes ndërkaq, që njihen me emrin "*Gjuhë të Lindjes*", duke u bërë të rëndësishme gjithnjë e më shumë në Evropë, që para një a dy shekujsh, përveç në kryeqytete, si për shembull, në Lajden dhe në Lajpcig, edhe në qytete të tjera të mëdha, gjenden shumë e shumë shkolla, biblioteka dhe shtypshkronja të mëdha e të veçanta për këto gjuhë. Falë këtyre mjeteve dhe lehtësimeve, janë ngritur dijetarë e specialistë në shumë gjuhë. Edhe këta, duke i krahasuar gjuhët që i dinin dhe, duke i shënuar e duke i regjistruar lidhjet e marrëdhëniet midis tyre, nxorën në shesh *gjuhësinë*.

Zbulimi i gjuhës së lashtë indiane, që quhet *sanskrit* dhe i gjuhës së vjetër iraniane, që i thonë *zend*, thujse ka hapur një derë të ndritshme për gjuhësinë. Gjurmët e këtyre gjuhëve, që shihen te gjuhët që fliten sot në çdo anë të Evropës, tregojnë dhe paraqesin një pjesë shumë të rëndësishme të paregjistruar të historisë njerëzore dhe, iluzionet që janë formuar mbi bazën e një mendimi krejtësisht të gabuar të gjuhës ebreje, si gjuhë nënë e gjuhëve të tjera, janë shembur dhe janë zëvendësuar me gurthemelin e gjuhësisë. Pastaj, gjuha ebreje, asiriane dhe arabe dhe veprat që i kanë lënë pas vetes disa popuj të lashtë, si: fenikasit, egjiptasit, asirasit dhe, nga një anë, duke u hulumtuar, duke u studiuar dhe duke u krahasuar gjuhët: turke, mongole, ujgure, jakute, labone dhe maxhare, të gjitha këto kanë shërbyer mjaft shumë në përhapjen dhe përparimin e gjuhësisë.

Shkenca, arti dhe teknika janë një oqean i tillë, që njerëzit e vyeshtëm, si për shembull, Kristofor Kolombo, janë zhytur në thellësi të tij me shpresë që të gjejnë vetëm një pjesë toke, një breg apo një ujdhesë. Ata nuk ktheheshin prapa përderisa nuk arrinin të zbulonin territore të mëdha dhe, sigurisht që, sa më tepër që zbulonin vende të reja, aq më tepër rritej edhe lakmia e tyre për zbulime të tjera. Ata, posa filluan të mësojnë gjendjen dhe lidhjet e gjuhëve të përmendura më lart, që në fillim ishin shumë pak të njohura, vazhduan të thellohen dhe të hulumtojnë degët e ndryshme të tyre, nga njëra anë, dhe flijuan jetën e tyre në rrugën për të mësuar gjuhët e kombeve e të popujve të ndryshëm, të cilët ishin të vendosur në pesë kontinente, derisa arritën madje te popujt primitivë të Afrikës Qendrore dhe të Amerikës, nga ana tjetër.

Megjithatë, njohuritë që u zbuluan deri më tash, ato janë të pakta në krahasim me të vërtetat që janë akoma të panjohura. Krahas kësaj, për të mësuar gjuhën e një populli që gjendet në skajin më të largët të Afrikës dhe të Amerikës, dijetari gjatë hulumtimit, kalon jetën më të çmueshme të tij dhe në atë rast, sado që sakrifikon veten, ai, megjithatë, lë kujtim ndonjë vepër, si: *gramatikë, fjalor, fjalë të urta, frazeologjizma ose përmbledhje këngësh dhe tregimesh*, të cilat janë çelës të asaj gjuhe.

Tani, pas gjithë kësaj, për të mësuar atë gjuhë, nuk ka nevojë të shkosh aq larg dhe të rrezikosh të futesh në vështirësi e rreziqe, sepse çdonjëri e ka bibliotekën e vet⁶, dhe, du-

⁶. Thuhet se Sami Frashëri ka pasur 12.000 libra në bibliotekën e tij personale (M.P.).

ke i shikuar e duke i shfletuar ata libra, do të mund të mësojë dhe do të mund të krahasojë me një lehtësi më të madhe gjuhët e popujve, që gjenden në skajin tjetër të botës.

Ja pra, në saje të përpjekjeve të këtilla, te popujt e qytetëruar, gjuha zhvillohet e përhapet nga dita në ditë dhe pikërisht për këtë, gjenden shoqata të mëdha të formuara nga dijetarë të çmuar e të mirfilltë dhe nxirren vazhdimisht publikime periodike.

Kjo shkencë te ne akoma është e panjohur. Përveç disa artikujve sipërfaqësorë dhe të shkurtër, që i kam shkruar para disa vitesh në gjuhën turke-osmane⁷, lidhur me këtë çështje nuk është shkruar asgjë më tepër, prandaj, është e qartë që edhe emri i saj të mos njihet sa duhet. Ne, megjithatë, jemi në një gjendje dhe në një pozitë që mund ta hulumtojmë këtë shkencë akoma më mirë se të gjithë kombet dhe popujt e tjerë, sepse për ta mësuar drejt këtë gjuhë (turqishten-osmanishten-M.P.) në gjendjen e tanishme, duhet të mësohen tri gjuhë, domethënë, përveç turqishtes duhet të mësohet edhe arabishtja dhe persishtja. Kur të arrihet një përparim, nuk e di nëse një ditë kjo gjuhë do të pavarësohet. Këto tri gjuhë u takojnë grupeve të ndryshme të gjuhëve. Gjuhët që fliten në rruzullin tokësor, ndahen në shumë grupe, por, janë tri grupe më të rëndësishme dhe më të afërta në botën e qytetëruar: *gjuhët ariane*; *gjuhët semite e hamite* dhe *gjuhët turanike*. Kështu, arabishtja është nga gjuhët më të njohura të gjuhëve *semite*, persishtja nga ato *ariane* dhe turqishtja nga gjuhët *turanike*.

Domethënë se gjuha (turke-osmane-M.P.) që flitet dhe, pikërisht, që flitet dhe shkruhet, është në lidhje të ngushtë me gjuhët: mançuanë, mongole, ujugure, jakute lapone dhe maxhare, që fliten madje deri në Lindjen e largët të Kinës, në Evropë dhe në Sibirinë më veriore, nga njëra anë; me gjuhët e lashta, si: ebraishten, asirianishten, haldeishten e me shumë gjuhë të tjera që fliten në Afrikën Veriore, nga ana tjetër, dhe me gjuhën indiane, iraniane dhe të krejt Evropës, nga ana tjetër.

Tri gjuhët e përmendura, që janë nga më të mëdhatë e gjuhës letrare turke -osmane, janë të mjaftueshme për ne për të mësuar edhe për degët e tjera të këtyre tri grupeve të gjuhëve; për të dhënë idenë për hulumtimin e lidhjeve që ekzistojnë në mes tyre dhe, për të lehtësuar qëllimin e njohjes së këtyre tri gjuhëve. Të gjeturit e pikës, ku bashkohet vendi i këtyre tri grupeve të gjuhëve që i gjetëm, do të mund të sillte shumë lehtësi në këtë temë. Në një gjendje të këfillë, disa prej nesh, ashtu siç do të duhej të kishin vepruar arabët, nuk mund të shmangemi nga të mësuarit jo vetëm të rregullave të gjuhës çagataje, që është degë e gjuhëve turke, por, edhe nga rregullat e turqishtes osmane që flitet; disa prej nesh, e konsiderojmë si largim nga rruga e drejtë, të mësuarit, jo vetëm të gjuhës sanskrite dhe zende, por edhe të persishtes, që është nga gjuhët e muslimanëve; disa prej nesh ndërkaq, duke i konsideruar si kusht dobitë dhe fitimet materiale për të mësuar një gjuhë, të mësuarit kështu i konsiderojmë më budallaki dhe më kotësi se sa të fituarit e njëfarë rroge.

Ja pra, për shkak të ndarjes së mendimit tonë të përgjithshëm në këtë mënyrë të çuditshme, nuk kemi akoma tek ne një shkollë të posaçme e të ngritur në një shkallë për të mësuar jo vetëm gjuhët, si: *sanskrite*, *asiriane* dhe *ebreje*, të cilat, duke pasur ndikim në një gjuhë letrare të përgjithshme në Evropë, studiohen vazhdimisht në çdo vend të

⁷. Revista "Hafja" (Java) nga numri 1 deri në numrin 8 (S.Frashëri).

saj, por edhe për gjuhën *arabe*, që e konsiderojmë më se të nevojshme. Dhe, kështu, një shkencë me emrin **gjuhësi** ka mbetur për ne ende e panjohur.

Ndryshimi në mes njeriut e kafshëve për sa i përket zërit

Të folurit e artikuluar, që formohet nga çfarëdo zërash të ndryshëm, është veçori vetëm për gjininë (racën) njerëzore. Edhe pse këtë veçori nuk e ka asnjë kafshë tjetër, këtë veçori, megjithatë, nuk e pranojmë në një formë a mënyrë kështu të përgjithësuar. Kur e analizojmë dhe e zbërthejmë në kategori (në pjesë), do të kuptojmë se formohet dhe përbëhet nga dy gjëra themelore; *e para*, jo nga britma, ushtima, ulurima por, nga të nxjerrët e zërit nga goja dhe, *e dyta*, nga të shprehurit e qëllimit, në çfarëdo mënyre qoftë, domethënë me zë, me shenja a me sinjale, me lëvizje ose me gjendje dhe sjellje.

Tash, t'i marrim në shqyrtim të dyja këto çështje themelore në mënyrë të veçantë dhe t'i shpjegojmë ndryshimet që janë në mes njeriut dhe kafshëve të tjera. Sa për ilustrim, ta vëmë edhe njeriun në mesin e kafshëve të tjera dhe t'i provojmë në mënyrë të paanshme, nëse mund të jemi (të bëhemi) të aftë ta ruajmë gjendjen e një provuesi (zgjedhësi) të drejtë dhe të paanshëm, atëherë, çfarë rezultati do të nxjerrim nga kjo provë? Kur t'ua vështrojmë gjuhën nga aspekti i përgjithshëm, do ta shohim gjendjen në të cilën ekziston ajo, domethënë, do të kuptojmë se në këtë çështje ka një dallim të madh, të pakrahasueshëm në mes njeriut dhe kafshëve të tjera. E pra, a do të duhej të bëjmë përjashtim dhe t'i pranojmë edhe kafshët e tjera në provim? Haj, medet! Nuk mund të lëkundemi fare që njeriut – të themi me shprehjen shkollore – t'i japim vlerësim a notë të plotë, kurse kafshëve të tjera t'ua zbresim notat shkallë-shkallë (në shkallën më të ulët) dhe disa llojeve të racës njerëzore, veç se t'u japim së paku një a dy ylla. Edhe në këtë aspekt, ashtu si në aspekte të tjera, njeriu është shumë më i përsosur se kafshët e tjera, kjo është gjë e pakontestueshme. Në mes njeriut dhe botës shtazore ekzistojnë dallime të mëdha nga ana shpirtërore, mendore, nga aftësia e të kuptuarit, nga ndjenjat, të folurit etj., shkurt, do të kuptojmë se ekzistojnë dallime e ndryshime nga çdo pikëpamje, jo vetëm nga ana cilësore, po edhe nga ajo sasiore. Në të vërtetë, te të gjithë do të shohim gjendjen e njëjtë, por te kafshët, atë gjendje do ta shohim në një shkallë shumë të ulët, me shumë të meta, kurse te njerëzit, në një shkallë shumë të lartë, të përsosur. Në këtë çështje jemi bashkëmendimtar me mistikët, sepse jemi të disponuar të pajtohemi se shpirti i njeriut dhe i kafshëve të tjera ka të njëjtin burim, por dallohen mes tyre në faktin se shpirti i njeriut ka elemente të shumta për t'u zhvilluar, kurse shpirti i kafshëve nuk disponon këso elementesh.

T'i shtjellojmë veç e veç dy gjërat themelore të gjuhës, që u përmendën më lart. Së pari t'ia fillojmë nga zëri.

Zëri mund të definohet si një tingull shtazor. E sa i përket tingullit, është e ditur se ai është një gjendje që formohet nga shtypja e ajrit. Zëri është një tingull (tingëllim) i ajrit, që e tingëllojnë kafshët për të marrë frymë, e që shfaqet kur kalon nëpër fyt dhe gojë. Fyti, skërfyelli, vrimat e hundës, gjuha, dhëmbët, buzët dhe hunda e kafshës janë organe që mund t'i japin forma dhe mënyra të ndryshme këtij tingulli. Nuk e shohim të

arsyeshme te ndalemi e të japim shpjegime të hollësishme lidhur me çështjen fiziologjike, sepse ajo gjë është jashtë temës sonë, por do të kënaqemi me shpjegimin se zëri është nga rezultatet natyrore të natyrës (karakterit) së kafshëve. Sot shkenca dhe teknika kanë arritur suksese që të shpikin një makinë madje të zhvilluar, e cila përmban gojë, hundë, gjuhë dhe organe të tjera të sajuara (artificiale). Është shpikur një makinë që shqipton të gjithë tingujt (bashkëtingëlloret dhe zanoret) që i përdor njeriu dhe mund t'i shqiptojë ato zakonisht si njeriu.

Thënë shkurt, meqë zëri është veçori fiziologjike që rezulton nga mënyra e zhvillimit dhe funksionimit të organeve anatomike, që gjenden në kanal të frymëmarrjes, të gjitha kafshët, që i kanë të përshtatshme organet e përmendura për këtë, janë të afta që në mënyrë teorike të shqiptojnë e të riprodhojnë çdo zë (tingull). Meqë, formimi dhe zhvillimi i organeve të përmendura nuk është i njëjtë te të gjitha kafshët, nuk do të ketë mundësi që çdo lloj kafshe të ketë aftësi të nyjëtojë të gjitha format e zërave. Pastaj, meqenëse edhe të folurit, të mësuarit, shprehia dhe trajnimi, kanë një rol të madh për këtë çështje, zërat që ka mundësi e aftësi t'i shqiptojë çdo kafshë, madje dhe çdo njeri, në mënyrë teorike, nuk do të ketë mundësi e aftësi t'i shqiptojë në mënyrë praktike.

Meqenëse këtë dallim e ndryshim do të mund ta gjejmë në mesin e njerëzve, nuk është e nevojshme ta kërkojmë në mes njeriut dhe kafshëve të tjera. Sado që disa kombe dhe popuj kanë mundësi të nyjëtojnë nga tridhjetë deri dyzet tinguj, disa prej tyre ndërkaq, nuk kanë mundësi e aftësi të nxjerrin a të riprodhojnë madje më shumë se pesëmbëdhjetë tinguj. Ky dallim, po të ishte vetëm në mes llojeve, ndoshta do të mund t'i ngarkohej krahasimit anatomik (organeve të ndryshme anatomike të tyre) dhe shkakun e tij do të përpiqeshim ta gjenim në formimin dhe në zhvillimin e organeve tingullore. Mirëpo, meqenëse këto dallime paraqiten edhe në mes kombeve dhe popujve që i përkasin një lloji a një fare, bëhet e qartë se nuk duhet mbështetur në shkaqet anatomike dhe fiziologjike, por vetëm në rezultatet e trajnimit (ushtrimit) dhe mësimin. Për shembull, kush mund ta detyrojë e ta shtyjë një turk, një francez, një gjerman, një maxhar (hungarez), një rus, të nyjëtojnë tingujt arabë **s** dhe **z**⁸, tingujt grekë **theta** dhe **delta**, tingullin anglez **th**; ose një grek, tingujt e turqishtes **ş** (=sh), **c** (=xh), **b**, **d**; e sidomos, një njeri që nuk është arab dhe nuk ka mësuar të lexojë Kur'anin derisa ka qenë vogël, ta shtyjë të shqiptojë tingujt e arabishtes **ajn**, **s**, **d**, **t**, **z**, **h**?⁹.. Kinezët nuk mund t'i shqiptojnë tingujt **r**, **b**, **d**, **v**, **z**; peruanët tingujt **b**, **d**, **f**, **ğ** (e afërt me **g**), **s**, bano-rët vendas të Amerikës Veriore tingujt **b**, **d**, **f**, **j** (=zh), **p**, **v** dhe, kur i dëgjojnë ata që i shqiptojnë këta tinguj, atyre u duket e çuditshme, por më tepër u duket e çuditshme dhe e pazakonshme se si e nyjëtojnë arabët tingullin **ajn** që shqiptohet nga thellsia e fytit. Populli që nyjëton më së paku tinguj është populli i Zelandës së Re. Këta mund të nyjëtojnë vetëm tingujt **b**, **k**, **d**, **f**, **ğ**, **j** (=zh), **l**, **s**, **v**, **y**(=j), **z**. Edhe nga kjo kuptohet se tingujt që mund t'i nyjëtojë njeriu janë të pakufizuar. Dhe, përveç tingujve që i dëgjojmë e nuk mund t'i nyjëtojmë, me siguri, ka tinguj që s'i kemi dëgjuar fare dhe, përveç tingujve që i nyjëtojnë popujt dhe kombet e ndryshëm, me siguri ka tinguj që nuk i nyjëton asnjë popull e komb, por ka edhe tinguj që do të mund të nyjëtohen. Po të mos e dëgjonim tingullin **ajn** nga goja e arabëve, a do të kishim besuar se ekziston një tingull i tillë karakteristik?

Të shohim tani dallimin në mes njeriut dhe kafshëve të tjera lidhur me këtë temë.

⁸ Fjala është për tingujt **th** dhe **dh**, të cilat në turqishten nyjëtohen **s** dhe **z** (M.P.).

⁹ Tingujt emfatikë, që janë karakteristikë vetëm për gjuhën arabe (M.P.).

Gjeologjia është shkenca që na mëson se kafshët, të cilat kanë ekzistuar në shtresat më të lashta të formimit të rruzullit tokësor; që kanë dalë më së pari në rruzullin tokësor dhe që kanë jetuar në periudhat më të lashta, kanë qenë pa tingull. Në ato kohë ajri – që sot është i lëngshëm dhe i fortë –, meqë ka përmbajtur shumë lëndë në gjendje gazi dhe, meqë ka qenë shumë i rëndë, nuk ka qenë i përshtatshëm të shpërndajë e të përçojë zërin. Edhe sot e kësaj dite ka lloje të kërmijve, të guaskave të detit, të ujqve, të hardhucave dhe të peshqve që janë pa tinguj (zëra). Edhe tingulli (zëri) i gjarprit formohet nga një fëshfërimë. Te sisorët paraqitet zëri fillestar i lindjes, i cili dobësohet mjaft shumë kur rritet ai. Sado që shumica e shpezëve riprodhojnë zë dhe melodi, që do të mund të shpreheshin me nota muzikore më tepër se zërat që do të mund të shpreheshin me shkronja, do të gjenden edhe gjallesa që do të shqiptojnë pa farë ndryshimi zërat që i shqipton njeriu. Llojet e papagajve dhe disa lloje të shpezëve që rriten në Amerikë dhe në Afrikë, janë të afta të shqiptojnë çdo tingull që e dëshirojnë. Ata imitojnë tingullin a zërin e çdo kafshe të egër. Ata, madje i nyjetojnë edhe fjalët e njeriut, si kur janë në kafaz, si kur janë në shtëpi dhe, deri në një masë, i përdorin të gjitha me vend dhe shumë mirë.

Përveç këtyre shpezëve imitues, edhe tingujt e zakonshëm që i nxjerrin shumica e shpezëve, duke iu ngjarë me përpikëri tingujve që i nyjton njeriu, do të mund të shkruhen me shkronja. Të kënduarit e *qyqes* (turq. guguk/kuku) nuk është asgjë tjetër përveç se përsëritje dhe shqiptim në mënyrë të qartë dhe shumë të kthjellët të këtyre dy rrokjeve që formojnë emrin e saj. A mund të dyshojë dikush se tingujt e shpezëve formohen nga rrokjet: ai i sorrës nga “ga”, ai i macjes nga “mijau”, e ai i lopës nga “mo/mu”? Gjatë të kënduarit të laraskës hetohet se tingujt **k** dhe **r** nyjtohen prej saj sikur dalin nga goja e njeriut. Kjo gjendje hetohet shumë mirë sidomos te tingujt zanorë, për shembull, është e ditur se hingëllima e kalit vërtetohet me tingullin zanor **i**, pëllitja e lopës me tingullin zanor **o**, blegërima e deles dhe e dhisë me tingullin zanor **e**. Megjithatë, nuk duhet kërkuar dhe insistuar me këmbëngulje të shpjegohet se të kënduarit e zakonshëm të disa shpezëve i ngjan ndonjë fjale të kuptueshme (që ka kuptim) të njeriut. Nëse i kushtohet kujdes të kënduarit të dallëndyshes, do të mendohet se po e lexon suren e Kur’anit “*Kul uhije*” deri te “...*ile-r-ushd*”.¹⁰ Një udhëtar anglez, i cili ka shëtitur pyjet e pashkelura dhe të pabanuara të Amerikës, në një rast si papritmas dëgjon pyetjen *Who, are you? Who, who are you?*, domethënë “Kush jeni ju?”, “Kush, kush jeni?” dhe kur kthen kryet, me një habi të madhe, sheh diçka të mirë, të bukur. Sheh një shpend paksa të vogël, që rrinte në një degë! Shpendi i gJORë, as pyeti se a di anglisht udhëtari dhe, as çfarë ishte qëllimi dhe dëshira e tij. Ai i gJORë ia thotë këngës së tij të zakonshme, por të kënduarit dhe aftësia e tij për të shqiptuar çdo tingull i ngjante fjalës së një njeriu. Udhëtari, i cili vazhdoi rrugën, pa u ndalur t’i përgjigjej pyetjes, pakëz më andej arriti të dëgjonte një shpend tjetër, që thoshte disa herë *Work away*, domethënë, “Shporru prej aty!” Ndonëse mund të numërojmë edhe shumë shembuj të këtillë, vëllimi i veprës sonë na detyron ta ndërpresim fjalën.

Shpezët imitues, sado qofshin si papagalli, sado që kanë aftësi dhe mundësi të imëtojnë dhe të shqiptojnë pothuajse çdo zë e tingull të njeriut, ne mund të qëndrojmë këmbëngulës në qëndrimin tonë se njeriu, megjithatë, mund të nyjetojë shumë më tepër tinguj se çdo kafshë veç e veç; vetëm se nuk mund të mohojmë se zërat që i riprodhojnë (nxjerrin) kafshët në një mënyrë të bashkuar janë më shumë se tingujt (zërat) që i shqipton njeriu. Nëse përcaktojmë nga një formë për ta përshtatur çdo tingull të ndryshëm që e shqiptojnë të gjitha kombet dhe popujt; numri i këtyre shkronjave të për-

¹⁰. Surja *Xhinn*, ajetet 1-2 (m.P.).

gjithshme ndoshta do të kalojë pesëdhjetëshin, por nëse dëshirojmë t'i përshkruajmë zërat (tingujt) e kafshëve përgjithësisht me forma të ndryshme, për këtë nuk do të mjaftojnë madje pesëqind shkronja.

Thënë shkurt, për njeriun nuk është përparësi e veçantë, se mund të nxjerrë tingull (zë) nga goja, e as aftësia e tij për të dhënë forma të ndryshme për atë tingull; njeriu edhe me këtë begati të natyrshme të tij ka ngjashmëri me kafshët e tjera, por ka diçka më tepër se kaq, dhe ai është qëllimi që synon.

Është i natyrshëm apo i përftuar zëri?

Pasi treguam se zëri i njeriut dhe i shumicës së kafshëve është i njëjtë kur del dhe , pasi treguam po ashtu se vetëm kafshët e grupit më të ulët janë të zhveshura nga këto karakteristika, tani hasim në një çështje tjetër. Është çështja se zëri, qoftë te njeriu, qoftë te kafsha, është natyror apo lidhet me të mësuarit, pra i përftuar.

Çdonjëra nga këto dy alternativa ka ithtarët e vet dhe të dyja alternativat kanë madje argumentet e tyre, të shumta dhe të fuqishme. Sado që duket shumë afër mendjes se zëri, në radhë të parë, është i natyrshëm, gjenden argumente dhe shembuj shumë të qartë që do ta hedhin poshtë këtë mundësi. Megjithatë, duke iu nënshtruar këtyre argumenteve, është gabim edhe të besosh se zëri mbështetet në të mësuar dhe në praktikë. Që të mund të nxirret një mendim i drejtë nga kjo çështje, duhet zgjedhur mesin e dy mundësive, e dy alternativave. Në fillim duhet gjetur dallimin dhe ndryshimin e veçorive “teorike” dhe “praktike” dhe pastaj ndarjen dhe dallimin e “tingullit” dhe “zërit”.

Duke e përqendruar vëmendjen në këto dy pika, mund të themi që: tingulli është natyror, kurse zëri është i përftuar dhe, prandaj, lidhet me të mësuarit. Sepse, tingulli formohet nga shtyrja e ajrit me shumë pak fuqi, kur goja është vetëm e hapur. Ai del në mënyra të ndryshme, varësisht nga krijimi i fytyrës, gojës dhe hundës së kafshës, prandaj, ndryshimi dhe dallimi që është në mes tingujve të kafshëve është si ndryshimi dhe dallimi që është në mes tingujve që dalin nga ndeshja a përplasja e trupave të ndryshëm, vetëm se është natyror, i natyrshëm. Sa i përket zërit, ai është i formuar nga një mënyrë e veçantë që merr tingulli duke ndryshuar vendshqiptimin, qëllimisht dhe me vetëdashje. Në këtë gjendje, zëri është i përftuar, por, edhe ai, praktikisht lidhet me të mësuarit dhe teorikisht përsëri është i natyrshëm, sepse natyra ia ka përgatitur dhe ia ka përsosur organet anatomike dhe fiziologjike që, në një mënyrë do të mund të nxjerrin, të riprodhojnë atë zë. Nga ana teorike ekziston në natyrë dhe, derisa nuk mësohet dhe nuk ushtrohet, nuk mund të shfaqet as praktikisht. Gjërat që nuk dalin në shesh praktikisht janë aq të shumta, sa që, për pohimet tona, mendoj se nuk është e nevojshme të kërkojmë argumente.

Gjendja e njerëzve, që kanë lindur të shurdhër ose që e kanë humbur aftësinë e dëgjimit sa kanë qenë të vegjël, është e mjaftueshme të dëshmojë se tingulli është i natyrshëm dhe zëri është i lidhur ngusht me të mësuarit. Këta të pafatët (të shurdhët-M.P.), që e kemi bërë shprehje t’i quajmë memecë, nuk janë të pagjuhë, por për shkak se kanë qenë të shurdhër, nuk kanë mundur të mësojnë gjuhë. Po të ishte zëri i natyrshëm, atëherë nuk do të mund të kishte pengesa në mosnjohjen e fjalës, në nxjerrjen e tingullit nga çdo vendnyjtim dhe në nyjëtimin e të gjithë tingujve. Megjithatë, përveç ndonjë tingulli të paartikulluar, që nuk do të mund të përfaqësohej me asnjë nga këto shkronja, nuk do të mund të artikulohej asnjë tingull, domethënë, nuk do të kishte mundësi të riprodhohej a të nxirrej asnjë zë (fonemë). Këto janë çështje të njohura që i shohim për

ditë. Fëmija nuk ka mundësi të artikulojë zë (fonemë) derisa nuk i ka mbushur nëntë a dhjetë muaj, e ndonjëherë, derisa nuk i ka mbushur një vit a një vit e gjysmë dhe, kur ia fillon të flasë për herë të parë edhe zërat (fonemat) që i nxjerr, janë shumë të kufizuar dhe shumë të mangët, porse për disa vjet, vërtet, do të mund të shqiptojë zëra (fonema) të plotë. Por, posa lind, ai mund të nxjerrë ndonjë tingull dhe, me siguri, bashkë me frymëmarrjen e parë ai shqipton edhe tingullin paksa të vogël. Një fëmijë, që lind e rritet në Arabi, ku flitet me grykore, nuk do të mund të shqiptojë shkronjat **s** dhe **z** sikundër që i shqipton ai që rritet në Stamboll. Të gjitha këto rrethana janë prova që do të argumentojnë se edhe zëri është i lidhur ngushtë me të mësuarit.

Zëri, jo vetëm te njeriu, por edhe te kafshët, lidhet me të mësuarit dhe me të ushtruarit. Kështu, për shembull, klyshi i qenit, posa lind, mund të nxjerrë, të riprodhojë një tingull si duhet, varësisht nga mënyra e krijimit të gojës, fytit dhe hundës së tij, por, të lehurit do ta mësojë më pastaj. Zogjtë (të vegjlit) e bilbilit, derisa ta bëjnë shprehi, derisa të mësojnë të këndojnë në pranverë, do të mundohen si një nxënës fillestar në konservatorium dhe madje, përderisa nuk do të mund ta përsosin të mësuarit e tyre në vitin e parë, do të vazhdojnë të këndojnë në mënyrë jo të shkathët, si fillestarë dhe, dihet se, pasi të ushtrohen dhe, pasi të bëjnë përpjekje të vazhdueshme do t'ia dalin të fitojnë shkathtësi në vitin e dytë. Nuk ka ndodhur dhe nuk do të mund të ndodhë asnjëherë që një papagall, i cili nuk ka dëgjuar zë macje në jetën e tij, të ketë mundësi ta riprodhojë këtë zë, zërin e macjes. Ky shpend, që ka aftësi të shqiptojë çdo tingull, do të ketë mundësi dhe aftësi për imitim, pasi të dëgjojë zërin e çdo kafshe dhe, pasi ta ushtrojë një kohë të gjatë atë. Edhe kanarina dhe zogjtë e tjerë të kafazit, do të aftësohen të riprodhojnë zërin a melodinë e një harmonike të vogël, pasi ta kenë dëgjuar vazhdimisht zërin e saj. Që ata do ta kenë arritur këtë duke ushtruar dhe duke mësuar, këtë është në gjendje ta vërejë çdokush.

Meqenëse zëri përftohet në këtë mënyrë, pra me të mësuar dhe me të ushtruar, atëherë, përse vetëm disa shpezë, si kanarina dhe papagalli, kanë mundësi të mësojnë zërat e atyre që nuk i takojnë llojit të tyre dhe, përse kafshët e tjera mund të mësojnë vetëm zërin që e dëgjojnë nga nënat e veta ose nga kafshët e të njëjtit lloj? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e kemi dhënë më lart, por, megjithatë, po ritheksojmë se zëri është i natyrshëm nga pikëpamja teorike. Papagalli ka aftësi dhe mundësi të riprodhojë a të nxjerrë teorikisht çdo zë që e dëgjon. Edhe kanarina ka aftësi të këndojë çdo melodi dhe, meqenëse këtë shkathtësi ua mundësojnë organet, si: goja, fyti, gjuha, ato, pasi të kenë dëgjuar dhe ushtruar vazhdimisht, do të mund të aftësohen t'i vënë në përdorim edhe në pikëpamje praktike. Mirëpo, për shembull, viçi aftësohet teorikisht vetëm sipas pëllitjes së gjedhit (lopës a kaut). Ky, ka aftësi të mësojë vetëm këtë, meqë organet, si: goja, fyti, gjuha, nuk i japin mundësi më shumë se kaq.

Ndryshimi dhe dallimi në mes njeriut e shtazëve të tjera në kuptim e në shprehje

Në dy kapitujt e kaluar kemi dëshmuar se zëri nuk është i veçantë vetëm për njeriun, sepse, edhe kafshët e tjera janë të afta të shqiptojnë zëra të ndryshëm, e sidomos disa shpezë, si papagalli, të cilat i afrohen njeriut më së shumti në këtë pikëpamje. Në këtë gjendje, të folurit nuk është i veçantë për racën njerëzore, dhe, a duhet thënë për shembull, për papagallin që flet? Haj, medet! Të folurit nuk është gjë e përbërë vetëm nga shqiptimi i atyre zërave, e madje, as nga shqiptimi i atyre fjalëve të plota e të përsosura. Të folurit do të thotë, të shprehësh qëllimin dhe të kuptosh qëllimin, që shprehet me fjalë dhe fjali, të formuara me zëra të artikuluar a fonema. Megjithatë, askush nuk ka parë se ekziston një komunikim në mes një njeriu dhe një papagalli ose në mes dy papagajve. Kur papagalli i interpreton fjalët që i ka mësuar nga njeriu, nëse ka diçka që ai ka menduar, edhe ajo gjë do të mund të jetë formuar nga ideja a mendimi për ta imituar njeriun; e kur i përdor disa herë ato fjalë në vend të përshtatshëm, për shembull, fjalën e tij (të njeriut) “*kush është*”, kur troket dera, me të dëgjuar se atë fjalë e ka përdorur njeriu në atë vend, ai është në gjendje ta realizojë në një mënyrë të përsosur vetëm imitimin e asaj fjale, e jo pse e kupton domethënien e saj.

Gjuha pra, nuk është e përbërë vetëm nga të folurit e fjalëve, që formohen nga fonema (zëra) të ndryshme. Kjo kushtëzohet me të shprehurit e qëllimit dhe mendimit me fjalë dhe, gjithashtu kushtëzohet me të kuptuarit të qëllimit, që shprehet me fjalë. Ky kushtëzim është veçori vetëm e njeriut? Kafshët e tjera a nuk mund t’i shprehin ndonjë qëllim njëratjetrës ose njeriut dhe, a nuk mund të kuptojnë ndonjë qëllim që synohet t’u shpjegohet atyre? Kur t’iu përgjigjemi këtyre pyetjeve, nuk duhet të nxitojmë. Duke u mbështetur në mundësinë e shqiptimit të disa fjalëve të papagallit me anë të imitimit, do të jetë gabim të besosh në të folurit e kafshëve dhe, duke u mbështetur dhe në faktin se kafshët nuk kanë aftësi dhe mundësi për të folur si ne, do të jetë po aq e padrejtë të mendosh e të gjykosh se kafshët në asnjë mënyrë dhe asnjëherë nuk kanë aftësi e mundësi për të kuptuar e për të shprehur qëllimin e tyre.

Megjithatë, kur shtrohet çështja e krahasimit në mes njeriut e kafshëve të tjera, për çfarëdo çështje qoftë, rezultati është i qartë: dallimi dhe ndryshimi në mes tyre qëndron pikërisht në përsosmëri dhe në mangësi; te njeriu nuk ka asnjë veçori që është sado pak e përsosur që te kafshët të mos jetë e mangët. Meqenëse shkalla e aftësisë te bota shtazore është e ndryshme, edhe shkallët e mangësisë janë të ndryshme.

Të kuptuarit dhe të shprehurit janë dy llojesh: *e para* shprehet me tundje a lëvizje të kokës, me shenja, ose me disa veprime të tjera, që vërehen në sjellje, në pamje, në qëndrim dhe në lëvizje dhe, *e dyta* shprehet me tingull dhe me zë. Që të dyja këto metoda a mënyra i shohim të pranishme edhe te kafshët, por në një masë më të vogël. Madje, mund të themi se mënyra a metoda e parë është tipar që gjendet te njeriu, e deridiku edhe te disa kafshë. Për shembull, shikojeni një qen me fytyrë të qeshur ose me qëndrim përkëdhelës, ai do të fillojë menjëherë të lajkatohet, duke e lëkundur bishtin dhe nga ana tjetër, shikojeni atë me hidhërim ose me kërcënim për ta rrahur, menjëherë do ta shihni atë si të zemëruar ose të frikësuar. Mjafton një veprim i çobanit për ta nxitur qenin e tij të sulmojë me një zemërim të madh dhe, po ashtu mjafton që me një veprim tjetër ta nxisë të qetësohet dhe ta ndërpresë menjëherë atë sulm dhe atë zemërim. Nga lëvizjet dhe veprimet e tilla të kafshëve, çdokush mund të kuptojë se në ç’ nivel janë ato. Këto gjëra mund

t'i provojë çdokush personalisht për çdo ditë. Për të përshkruar ndjenjat e kafshëve ndërkaq mund të bëhet një vëllim i veçantë, por nuk do të zgjatemi më tepër këtu, sepse edhe me kaq shembuj, mund të kuptohet qëllimi i temës sonë.

Sa i përket shtjellimit të metodës së dytë, domethënë, kuptimit dhe shprehjes së qëllimit me zë dhe me tingull, edhe te kjo, marrë në përgjithësi, nuk shohim diçka shumë të veçantë. Të gjitha kafshët që kanë mundësi dhe aftësi të riprodhojnë zë, mund ta përdorin atë zë në mënyra dhe në forma të ndryshme dhe kanë mundësi të shprehin shumë gjëra, varësisht nga nevoja, kërkesa, dëshira, ndjenja dhe shkalla e zgjuarsisë së tyre. Për shembull, kali riprodhon (nxjerr) tjetër zë kur kërkon ushqim, e tjetër zë kur kërkon pelë dhe, krejt tjetër zë kur trembet; quka, kur i thërret zogjtë për ushqim përdor tjetër zë, kur nuhat se do t'i kërcënohet ndonjë rrezik dhe, kur do t'i thërrasë ata nën sjetullat e veta, zë tjetër, edhe kur dëshiron që ata t'i vijnë prapa, zë tjetër, e nga ana tjetër, zogjtë, duke e kuptuar shumë mirë gjuhën e pulës, përkatësisht të qukës, nuk gabojnë në asnjë mënyrë për ta çuar urdhrin e saj në vend. Të kuptuarit dhe të shprehurit e qëllimit të kafshëve me zë, nuk ndodh vetëm në mes tyre, por, ato i kuptojnë edhe zërat e njerëzve dhe të kafshëve të tjera, që nuk janë të të njëjtit lloj. Dilni në hapësirë - dhe thirrni në mënyrë që qentë të dëgjojnë zërin e njohur, që është i veçantë për t'i thirrur në ushqim, do të shihni se, sa qen do t'i ketë perreth, do të vrapojnë dhe do të tubohen pranë jush; por, kur të përdorni zërin që është i veçantë për t'i thirrur pulat, qentë, asesi nuk do të lëvizin nga vendi dhe, pranë jush, natyrisht, do të mbledhen pulat. Qentë, macat dhe shumica e kafshëve të tjera i dinë emrat e tyre. Sado që do t'iu bërtitni atyre kur rrinë të qetë pranë jush, ato nuk shqetësohen, nuk i japin rëndësi bërtimës suaj, por, posa do t'i dëgjojnë emrat e vet, do t'i ngrisin kokat dhe do t'ju shohin në fytyrë sikur duan t'ju pyesin se çka dëshironi. Ndonëse te kafshët nuk ka ndonjë shembull, që do të mund të argumentonte e t'i dëshmonte në një mënyrë më të qartë e më të denjë pohimet tona, u përpoqëm të argumentojmë praninë e veçorive të kafshëve në bazë të rrethanave dhe situatave që i sheh çdokush për çdo ditë. Prandaj, jemi shmangur dhe nuk jemi zgjeruar shumë, duke u mbështetur në tregime të ndryshme.

Thënë shkurt, edhe kafshët e kuptojnë dhe e shprehin qëllimin e tyre, si me zë, si me shenja ose me sjellje, lëvizje dhe me veprime të ndryshme. Kjo veçori, që është mjaft e mangët te pjesa dërrmuese e kafshëve, te njeriu është shumë e përsosur. Por, pa dyshim, te njeriu është madje në shkallë të ndryshme. Çdo njeri dhe çdo popull është zotërues i gjuhës, varësisht nga nevoja dhe shkalla e zgjuarsisë dhe e qytetërimit të tij. Për shembull, banorët e Australisë e shprehin qëllimin me njëqind a dyqind fjalë dhe nuk dinë të numërojnë më shumë se pesë. Megjithatë, dallimi që është në mes njeriut më të qytetëruar dhe atij më primitiv, meqë është i parëndësishëm në krahasim me dallimin që ekziston në mes njeriut më primitiv dhe kafshës më të zgjuar, mund të themi se vetëm njeriu është ai që flet me një gjuhë të qartë e të vlefshme, që quhet gjuhë, dhe të gjithë njerëzit janë zotërues të gjuhës.

Duke u mbështetura në disa vlera të njohura e të ditura, nuk është vështirë që një gjë që nuk dihet e që nuk njihet, ta sjellësh në një gjendje që të njihet. Nga mendimet, të cilat i thamë deri më tash, i bëmë të njohura dy gjëra: *e para*, se edhe kafshët kanë gjuhën e tyre, ndonëse në një masë a shkallë të vogël; *e dyta*, se në mes popujve të qytetëruar dhe popujve primitivë, nuk shihet ndonjë ndryshim i madh nga aspekti gjuhësor. Një gjë që rritet gradualisht, shkallë-shkallë, pa dyshim se një ditë do të bëhet shumë e vogël dhe, një gjë që shumëfishohet gjithnjë e më tepër, pa dyshim se një ditë do të bëhet shumë e pakët, pra, ashtu siç do të ngrihet shkallë-shkallë, po ashtu edhe do të bjerë shkallë-shkallë. Shkalla e fundit e zvogëlimit dhe shkalla e fundit e pakësimit është “asgjëja” (hiçi). Kafshët, që u shfaqen më së pari në rruzullin tokësor dhe që gjenden sot në shtresën më të ulët, nuk kanë as zë e as tingull dhe as kanë aftësi e mundësi të shprehin e të kuptojnë qëllimin, kurse kafshët e tjera filluan t’i zotërojnë këto dy veçori shkallë-shkallë. Më pastaj, me plotësimin dhe me përsosjen e vazhdueshme të këtyre dy veçorive, te njeriu, që është krijesa më e përsosur, u shfaq **gjuha**.

Domethënë se gjuha nuk është gjë shumë e vjetër, ajo u shfaq më pastaj. Në kohë të lashta, kur u paraqit njeriu i parë, mendohej se ai qe shumë i përsosur, dhe pastaj, me kalimin e kohës, thuhej se, duke u prishur, mbeti prapa. Edhe gjuha, sipas asaj bindjeje, qe shfaqur menjëherë dhe në mënyrë e në formë të përsosur. Këta ithtarë, duke mos u kënaqur me këtë mendim, shkuan më tutje, për aq sa të besojnë se gjuha është më e vjetër se vetë njeriu. Prandaj, sipas besimit të brahmanëve të Indisë, njësia gjuhësore “fjalë/të folurit” (turq. söz dhe kelâm), ka ekzistuar, jo vetëm para njeriut, por edhe para krijimit të gjithësisë! Ky besim duhej të ketë ekzistuar, sepse poetët persianë, për shembull, Firdeusi, i jep një domethënie të veçantë fjalës a termit të persishtes “suhan” (shq. fjalë). Edhe Jovani (Juhanna), një nga apostujt, ka shpjeguar se termi “fjalë/të folurit” (arab. kelâm-M.P.), ka ekzistuar para krijimit të botës.

Megjithatë, të vërtetat që i dëshmon dhe i argumenton shkenca sot, meqë nuk kanë të bëjnë me legjenda të vjetra, nuk mund ta pranojnë një mendim të këtillë. Shkenca është dëshmuar sot me arsytetime dhe me argumente dhe, me të vërtetë, ka treguar në mënyrë të qartë se në shfaqjen e parë, njeriu ka qenë në një gjendje shumë të varfër e të mangët dhe ka qenë në një gjendje shumë afër gjendjes së kafshëve të tjera, por, me kalimin e kohës, ka përparuar shkallë-shkallë. Gjuha lidhet me përparimin mendor të njeriut. Njerëzit e tashëm primitivë, ndonëse dinë disa qindra fjalë, gjuha e të parëve të tyre, para disa miliona vitesh do të mund të ketë qenë, me siguri, edhe më e kufizuar. Nëse njerëzit e periudhës së katërt i konsiderojmë si primitivët e tanishëm, edhe ata bile kanë folur me gjuhët e formuara nga disa qinda fjalë dhe gjuhët e të parëve të tyre, natyrisht, kanë qenë edhe më të kufizuara. Në fund, pas gjithë kësaj që u tha, mund të nxjerrim përfundimin se njerëzit e parë, me gjasë, do të kenë qenë plotësisht pa gjuhë.

Sado që njeriu në paraqitjen e parë ka pasur shumë të meta dhe ka qenë në një gjendje shumë të prapambetur, megjithatë, ka qenë në një gjendje shumë më të përsosur dhe më të zgjuar se të gjitha kafshët e tjera, prandaj, nuk mund të mbetet farë dyshimi pse ai ka shkuar shumë përpara llojeve të tjera. Për këtë shkak, edhe pse njerëzit e parë nuk kanë folur me një gjuhë, që do të mund të quhej me plotë kuptimin e fjalës gjuhë, kuptohet se, me siguri, kanë pasur mundësi dhe aftësi të kuptojnë dhe të shpjegojnë qëllimin më mirë se kafshët më të zgjuara.

Po të ketë jetuar njeriu në kohën e tretë, shenjat, veprimet dhe zërat që i kanë përdorur ata njerëz, për t'ia shprehur qëllimin njëri-tjetrit, pa dyshim se nuk do të duhej të kenë qenë shumë të ndryshme nga ato që i kanë përdorur kafshët. Zaten, në ato kohë njeriu nuk dinte asgjë, sepse gjërave që i ka ditur, do të ishte i detyruar t'ua vinte nga një emër dhe kështu të mund ta shtynin të formonte një gjuhë. Mënyrën si t'i shënojnë kafshët nuk e ka ditur. Kafshët e egra i shihnte rrallë. Meqë, as ato nuk mund t'i dallonte nga njëra tjetra, të gjitha çiftet e tyre, me gjasë, i emërtonte me një emër. Por, edhe ai emër, si duket, ishte formuar nga një thirrje (bërtimë) dhe nga një zë i thjeshtë i bashkuar (i koordinuar) me shenjën e gishtit dhe të gjitha fjalët, ose , thënë më drejtë, të gjithë tingujt (zërat) që i ka përdorur në këtë mënyrë, ndoshta nuk kanë qenë më shumë se njëzet a tredhjetë. Me kalimin e kohës, ato, nga njëra anë, janë shumëfishuar, dhe, nga ana tjetër, duke dalur nga vlera e tingullit dalëngadalë, kanë hyrë në vlerën e zërit (fonemës) dhe pas disa kohësh kanë marrë vlerën e fjalës.

Ky përparim i tillë nuk u paraqit shumë lehtë. Meqë, siç dihet, ka mundur të formohet me miliona vjet, njerëzit kanë jetuar shumë kohë në një gjendje që do të mund të quhej pa gjuhë dhe, pas kësaj kohe, kanë folur me gjuhët me shumë mangësi, që, sadokudo, nuk do të mund t'i thuhet gjuhë. Madje, popujt primitivë, që banojnë edhe sot e kësaj dite në vende të ndryshme të rruzullit tokësor, flasin me gjuhë të këtilla.

Thënë shkurt, gjuha jo vetëm që nuk ka ekzistuar para paraqitjes së racës njerëzore, që është një mendim i çuditshëm, por ajo është një gjë që është shfaqur pas shfaqjes së njeriut ose, thënë më drejt, gjuha është një gjë që është shfaqur shkallë-shkallë.

Pajtohemi se gjuha, me gjasë, është shfaqur më pastaj, sepse njeriu është krijuar pa gjuhë dhe se shumë kohë, thuajse, do të ketë jetuar në atë gjendje. Është një çështje tjetër tani që meriton t'i kushtohet kujdes, e ajo është mënyra e shfaqjes së gjuhës. Pasi njeriu është krijuar pa gjuhë, si ka mundur të mendojë që çdo gjëje që e rrethon t'i vërë emër, ta emërtojë dhe, pastaj, çfarë lidhje ka në mes sendit që emërtohet me emrin që e emërton, për shembull, pse kalit i është dhënë emri "kalë", tokës "tokë", qiellit "qiell"? Kush i ka menduar këta emra, kush i ka vënë, kush i përgjithësoi ngjashmëritë në mes tyre; shkaku i emërtimit kush është? Po të ishte për shembull, emri i qiellit në çdo gjuhë në një mënyrë dhe në një formë që do t'i ngjante fjalës "qiell" (turq. *gök/semâ*), do të kishim mundur të themi se ka një lidhje në mes sendit që shenjon kjo fjalë me zërat që dalin nga një vendshqiptim i këtillë. Mirëpo, sendi që shenjohej në këtë mënyrë në gjuhë të tjera, meqë formohet nga zëra që dalin nga vendshqiptime krejtësisht të tjera, është e pakuptimtë të kërkosh një lidhje të këtillë. Prandaj, si u shfaqen këto fjalë dhe këto gjuhë në këtë gjendje, kush ka menduar t'i vërë një emër një gjësendi dhe si janë përkufizuar dhe përcaktuar këta emra?

Në lidhje me këtë çështje dhe me këtë temë mendimet e filozofëve janë të ndryshme. Shumica e të vjetërve, duke besuar se gjuha shërben për marrëveshje, kishin pranuar se njerëzit janë marrë vesh mes vete që, për shembull, asaj t'i themi ashtu e kësaj kështu. Porse, natyralistët e kohës sonë kanë dëshmuar se ky mendim është i pakuptimtë dhe krejtësisht i pabazë dhe kanë dëshmuar se nuk do të kishte mundësi të shfaqej gjuha duke u marrë vesh dhe duke bërë marrëveshje në këtë mënyrë. Në të vërtetë, nuk mund të pranohet një mendim qesharak dhe i çuditshëm sa të besosh se më të parët tanë kanë filluar të flisnin pa mos qenë të aftë të flasin asnjëherë e pa mos ditur ç'është gjuha dhe pa mos pasur edhe aftësi natyrore për të folur, të jenë marrë vesh pa mos i shënuar dhe pa mos u vënë emra mijëra gjësendeve dhe nocioneve, e t'i kenë mësuar përmendsh këta emra. Duke filluar që nga Platoni e deri para mëse një shekulli, ky mendim, që e kishin pranuar të gjithë filozofët dhe që e kishin shpjeguar me një kompaktësi të madhe, sot, sipas parimit shkencor, nuk është pranuar dhe është refuzuar krejtësisht.

Njeriu i parë është tubuar kështu në një vend, dhe kur nuk ka pasur aftësi dhe mundësi të mblidhet për t'u këshilluar, jo vetëm që nuk ka mundur të mendojë për të shpikur fjalë të këtilla të përsosura, por nuk ka qenë i aftë të riprodhojë asnjë zë, përveç tingullit. Nuk ka dyshim se tingulli që kanë mundur ta riprodhojnë njerëzit e parë, nuk ka asnjë dallim nga tingulli i paqartë (i paartikulluar) që e riprodhon një i pagjuhë që ka lindur i shurdhër. Është çështje që nuk dihet sesa ka mbetur njeriu në atë gjendje, të thuash, i aftë, të riprodhojë vetëm atë tingull të paqartë e të paartikulluar. Meqë njerëzit e parë kanë pasur veshë, dhe gojë, që ua kanë mundësuar atyre të nyjëtojnë çdo zë, atëherë, pa

humbur shumë kohë, mendohet se kanë pasur aftësi që të riprodhojnë duke imituar zërat që i kanë dëgjuar, kanë mundur të riprodhojnë shumë shpejt zëra të ndryshëm.

Fëmija i vogël, duke dëgjuar vazhdimisht zëra të ndryshëm nga njerëzit që janë të rrethit familjar, për një a dy vjet, e përfundimisht, për katër vjet do t'i mësojë krejtësisht. Ndërkaq, meqë njerëzit e parë, nuk kanë pasur të atillë që kanë folur në rrethin e tyre, atëherë nga cili do t'i kenë mësuar këto zëra? Jo vetëm në gjuhë, por edhe në shumë çështje të tjera, kafshët janë bërë mësuesit e parë të njeriut. Do të duket paksa e çuditshme që kafshët e pagjuhë të jenë bërë mësues, për t'ia mësuar njeriut gjuhën, pra kafshët katërkëmbëshe, pa aftësi kuptimi, të jenë bërë mësues, për t'u dhënë mend njerëzve. Kjo nuk është e pamundshme, por, përkundrazi, shumë e natyrshme.

Sikurse çdo njeri, që ka periudhën e fëmijërisë, edhe bota njerëzore përgjithësisht ka kaluar një periudhë (fazë) fëmijërore. Dhe, kjo periudhë është koha e shfaqjes së parë të saj. Sado që bota njerëzore ngrihet mbi të gjitha llojet e shtazëve, gjërat që do të mund t'i mësojë nga ata në fazën e fëmijërisë së saj, kanë qenë të shumta. Dhe, shkencëtarët shpikës, si, për shembull, Volteri dhe Njutoni, a nuk janë ata që kanë mësuar gjuhët dhe njohuritë e para nga mëndeshat dhe dadat e paditura të tyre.

Njeriu, duke u përpjekur vazhdimisht ta imitojë zërin karakteristik të kafshës që e sheh, ka fituar aftësi të shqiptojë e të riprodhojë zëra të ndryshëm. Vetëm se, fëmijëria e secilit njeri, në përputhje me rrethanat jetësore të tij, zgjat dy-tri vjet, fëmijëria e botës njerëzore, sipas natyrës jetësore të njeriut, zgjat shumë kohë. Për këtë arsye njerëzit që u shfaqen në periudhën e parë, deri sa u mësuan t'i imitojnë zërat e kafshëve, kaloi shumë kohë dhe, ata për këtë qëllim, kanë pasur shumë vështirësi dhe shumë mundime. Kur bie fjala se pse njerëzit kanë qenë të detyruar t'i imitojnë kafshët, ky detyrim, dhe përpjekja e tyre që t'i interpretojnë kafshët me imitim e zërave, kanë kaluar nëpër një rrugë të panjohur. Një njeri i pagjuhë për shembull, duke e parë një gjedh (ka ose lopë) të egër dhe, për ta gjuajtur atë, kur ka dashur t'i lajmërojë shokut të tij, duke e treguar vendin e gjedhit me gisht, ka qenë i detyruar ta imitojë këtë gjedh duke bërë titur "*moo/muu*", ose, një qyqe, duke dëgjuar se këndon një shpend dhe, kur ka dashur të lajmërojë, nuk ka pasur mënyrë tjetër përveç që të imitojë këtë shpend duke bërë titur "*kuku*". Ja pra, zanafilla e shfaqjes së gjuhës është bërë përmes kësaj mënyre dhe forme të imitimit.

Pasiqë njeriu ka mësuar njëherë të njëjtë zëra të ndryshëm nëpërmjet imitimit të kafshëve, megjithatë, imitimin nuk e ka përcaktuar vetëm zëri i kafshëve. Çdo gjendje, çdo ngjarje, çdo lëvizje, çdo veprim, njeriu madje ka filluar t'i shprehë duke i imituar me zë, me dorë, me këmbë, me kokë dhe me krejt trupin e tij. Ai nuk e ka imituar zërin përherë, qoftë të kafshëve, qoftë të gjësendeve dhe objekteve të tjera. Ai shumë herë ka imituar edhe lëvizjet dhe mënyrat e tyre, shkurt, ka imituar gjendjen e atyre gjësendeve që më së shumti kanë ndikuar dhe vepruar tek ai dhe, që i kanë rënë në sy më së pari. Ai ka arritur të dëgjojë më së pari zërin e qyqes, sorrës (galës) dhe shumë e shumë shpezëve të tjera. Këto i ka emërtuar sipas zërit të tyre; kalin, për shembull, e ka imituar sipas zërit të vrapimit të tij, lopën sipas zërit të kërcimit të saj të një muri a hendeku duke thënë **lop**; peshkun sipas shushurimës kur noton, duke bërë **fishk**. Atij pra, ia kanë tërhequr vëmendjen edhe shumë e shumë zëra të tjerë të këtyllë. Këto janë shkaqe që: në gjuhën sanskrite emri i kalit është **esve**, kurse në gjuhën persiane është **esb**. Ndërkaq, rrënja e fjalës që në gjuhët e përmendura dhe në shumë gjuhë të tjera jep kuptimet “vrapoj”, “ec”, “fryn”, “çon pluhur” (turq. yürümek, esmek, koşmak), është **es**. Me fjalët e sipërpërmendura janë të afërta: në turqishte, fjala “*esmek*”, kurse në gjuhën shqipe, fjala *éce* (=ecë -M.P.). Në gjuhën shqipe, emri i lopës është **lope** (=lopë-M.P.), kurse emri i peshkut, në gjuhën shqipe është **peshk**, në latinisht **piscis** dhe në gjermanisht **fisch**.

Nuk është lehtë madje të imitosh plotësisht, qoftë zërat e kafshëve, qoftë lëvizjet e gjësendeve dhe situatave të tjera. Meqë, njeriu nuk mund të përshkruajë me përpikëri gojarisht zërat e shumicës së kafshëve dhe sidomos zërin kur ecin kafshët ose, zhurmën e gjësendeve të pashpirt kur rrëzohen, kur përpiqet t'u afrohet atyre, ai menjëherë do të mund të riprodhojë zëra krejtësisht të kundërt. Madje sot, për shembull, një njeri që dëshiron të imitojë dhe të përshkruajë lehjen e qenit, do të thotë “*hav*”, tjetri “*av*”, tjetri “*ham*”, tjetri “*vau*”, e ndonjë tjetër “*buu*”, mirëpo qeni riprodhon zë tjetër, të ndryshëm nga të gjithë këta, dhe nuk është e mundur që njeriu atë ta imitojë me përpikëri dhe, sidomos, ta pasqyrojë me shkronjat ekzistuese. Pastaj, zhurmën (zërin) që e bën diçka, si për shembull, zhurmën e revoles kur zbrazet, çdo popull do ta përshkruajë e do ta thotë në mënyrën e vet: dikush “*pam*”, dikush “*bom/bam*”, dikush “*dank/dauk*”, dikush “*bo/bu*”, dikush “*gym*” etj.

Ja pra, te emrat që shfaqen me imitim të këtyllë, do të mund të shihen kundërthënie nga dy pikëpamje. Njëra nga këto, është emërtimi i çdo gjëje në mënyra të ndryshme, ose sipas gjendjes dhe mënyrës që i ka rënë në sy më së pari, ose sipas gjendjes dhe mënyrës që ka arritur ta dëgjojë, ose sipas zërit dhe zhurmës së gjësendit dhe, tjetra, për shkak të pamundësisë së imitimit me përpikëri të të njëjtës zë ose të së njëjtës zhurmë, përpiqet ta përshkruajë në mënyra të ndryshme. Përveç këtyre kundërthënive të natyrshme, edhe emrat e disa gjësendeve nuk shfaqen drejtpërdrejt nga zëri ose nga imitimi i rrethanave

të tyre. Shkaku i emërtimit të disave është aq larg ose është formuar në bazë të një rasti të tillë që, edhe nëse supozohet se ai emër gjendet në formë dhe në gjendje që i është vënë akoma sot për herë të parë, përsëri do të jetë e pamundshme të gjendet shkaku i emërtimit të tij.

Për të argumentuar dhe për të dëshmuar, si të thuash, këtë mendim timin, do të them se derisa jam duke i shkruar këta rreshta (lexo: Sami Frashëri-M.P.), vajza ime dhjetëmuajshe, duke qëndruar pranë meje, shpiku a sajoi një fjalë. Ajo qëndronte karshi stufës dhe derisa shikonte zjarrin me një habi fëmijërore, gratë, si zakonisht, ia treguan asaj këtë gjësend, këtë trup të çuditshëm me emrin **cis** (lexo: xhës-M.P.). Ajo iu shmang ta pranojë këtë fjalë që mësohet me kaq vështirësi. Duke i kushtuar vëmendje dhe kujdes zërit që e riprodhonte flaka ose rrësheku i farkëtarit, menjëherë ia vuri emrin zjarrit **puf**. Por, megjithatë, nuk është fëmija im i pari në botë që i ra ndërmend kjo fjalë. Me kuptime të afërta me këtë, ajo është përdorur në persisht dhe në gjuhë të tjera.

Njeriu nuk ka imituar dhe nuk imiton vetëm zërat, lëvizjet dhe veprimet e kafshëve dhe të gjësendeve të tjera. Ai madje ka imituar dhe imiton edhe vetë gjendjet dhe lëvizjet e tyre dhe, sidomos, bërtimat dhe thirrjet e tyre, prej të cilave janë sajuar, përkatësisht kanë lindur shumë fjalë të reja, sepse njeriu kur është shfaqur për herë të parë, sado që nuk ka qenë i aftë të flasë, ai që në zanafillë ka qenë i aftë të riprodhojë a të nxjerrë thirrje, bërtimë a tinguj, sepse këtë ia ka mundësuar gjendja e tij e natyrshme. Për shembull, kur lodhej, kur hidhërohej, kur gëzohej ose, kur ndiente ndonjë gjendje tjetër të brendshme, të ngjashme si këto, ai imitonte thirrmat, si: **ah!, ah!, oh!, of!, ha!, hi!**, nëpërmjet të të cilave ka mundur të kuptohej lodhja, zemërimi, gëzimi dhe ndjenja të tjera.

Thënë shkurt, atë që e bën çdo person në fëmijërinë e vet, të njëtën e ka bërë edhe gjinia njerëzore në kohët e shfaqjes së parë, që ka qenë periudha fëmijërore e saj. Ashtu siç e shprehin bërtimat, thirrjet “*pum*” rrëzuarjen e fëmijës; “*of*” hidhërimin shpirtëror; “*pat*” rrahjen; “*xhës*” djegien, në këtë mënyrë dhe me thirrje të ngjashme e kanë shprehur qëllimin e tyre edhe njerëzit e parë.

Sa i përket shfaqjes së gjuhës me mënyrën e imitimit të këtyre, natyralistët ndahen në dy grupe. Një lagje dijetarësh, duke mbajtur qëndrimin se gjuha ka lindur vetëm nga imitimi dhe se çdo kafshë dhe çdo gjësend është emërtuar sipas zërit dhe tingullit që e riprodhojnë, çështjen e imitimit e kanë avancuar në një shkallë të tepruar, dhe një lagje prej tyre, duke e refuzuar dhe duke mos e pranuar fare imitimin, kanë shpjeguar se janë të pakta kafshët që janë emërtuar sipas imitimit të zërave. Ithtarët e mendimit të dytë edhe më tutje e kanë të paqartë çështjen se në çfarë mënyre janë përcaktuar fjalët e thjeshta (të parme) që janë në rangun e rrënjëve të fjalëve ose të shumicës së fjalëve dhe, nuk i kanë të qarta diskutimet, për shembull, se rrokja “**de**” shpreh kuptimin e “*jap, me dhënë*” (turq. vermek) dhe rrokja “**ge**” ose “**ve**” shpreh kuptimin e “*shkoj, me shkua*” (turq. gitmek) dhe “*vij, me ardhë*” (turq. gelmek). Dhe, me siguri këta mendojnë se mendja e njeriut nuk do të jetë në gjendje ta zgjidhë asnjëherë këtë enigmë.

Meqenëse të dyja këto rrugë e kanë tepruar, mendoj se duhet kërkuar të vërtetën në mesin e këtyre të dyjave. Sado që të jetë gabim të mohosh krejtësisht imitimin ose, t’i përcaktosh vetëm disa fjalë që gjenden akoma në gjendjen e tyre themelore, si *guguk/kuku* “qyqe” dhe *kukumav* “qukapikth”, është po aq e papranueshme dhe e pakuptimtë edhe të pranosh se çdo emër ka lindur nga imitimi i zërit të gjësëdit që vetëm është emërtuar. Në radhë të parë, emërtimi nuk është i sajuar vetëm nga imitimi i zërit, sepse, siç kemi thënë më lart, nuk duhet harruar se do të mund të jetë temë shqyrtimi shumë herë edhe imitimi i një gjendjeje a i një rrethane ose i një lëvizjeje a i një

veprimi. Megjithatë, nuk është mendim i drejtë se të gjitha fjalët kanë lindur vetëm nga imitimi. Edhe njohja e këtyre të dhënave këtu është e nevojshme se njerëzit, sa herë që kanë dashur ta shprehin gjësendin në gjendjen e tij fillestare, fillimisht e kanë treguar me gishta, e pastaj janë përpjekur që imitimin e tij ta shprehin edhe me dorë, me këmbë, me fytyrë, me kokë dhe me tërë trupin e tyre dhe, për ta shprehur akoma në mënyrë më të qartë këtë përshkrim, veprimeve të lartpërmendura ua kanë shtuar edhe zërat e tingujt. Mirëpo, kur shprehnin a tregonin diçka, që nuk do të mund të imitohej me zëra, të pakënaqur vetëm me të shprehurit e shenjave, bënë përpjekje për ta përgatitur veten që, së bashku me ato shenja të riprodhojnë a të nxjerrin rastësisht edhe një zë a tingull. Edhe pse të pagjuhët e dinë se nuk do të mund të shprehin qëllimin me zërin e tyre, të pakënaqur me shenjat që shprehin diçka, ata riprodhojnë edhe një tingull a një zë, të cilin e dëgjon çdokush. Domethënë se karakteri i krijimit të tij e ka përgatitur njeriun që së bashku me shenjën, të riprodhojë edhe një tingull. Ja pra, në këtë kuptim, njëri nga njerëzit e parë, i cili ka dashur t'ia shpreh shokut të tij lëvizjet a veprimet “vij” dhe “shkoj”, i pakënaqur ta shpreh qëllimin e tij me shenjë, ka riprodhuar rastësisht dhe pa dashur tingullin **g** ose **v**, kur ka dashur të shpjegojë a të shpreh *afrimin* dhe *ardhjen*, ka riprodhuar tingullin **a** ose **e** dhe, kur ka pasur për qëllim të shprehë *tërheqjen* dhe *shkuarjen në largësi*, ka riprodhuar tingullin **i**. Këta zëra dhe këta tinguj janë mbështetur në marrëveshje dhe në pëlqim të veçantë. Të gjitha këto, në krye të herës, sigurisht janë thënë rastësisht, por me kalimin e kohës, njerëzit duke mësuar vazhdimisht nga njëri-tjetri, e më vonë, duke i përgjithësuar kështu, kanë filluar t'i shprehnin këto kuptime.

Ja pra, edhe fjalët që nuk janë sajuar nga imitimi, kanë lindur në këtë mënyrë. E shohim më të arsyeshme që në vend që t'i numërojmë shembujt, t'i shpjegojmë ata dy-tre shembuj që i dhamë më lart. Gjurmët e zërave (tingujve), që shprehin kuptimin e grupit të parë të shembujve “vij” dhe “shkoj” dhe dy shembujve të grupit të dytë, të cilët u përmendën më lart: “*ardhjen këndej*” dhe “*shkuarjen andej*”, i gjejmë në gjuhë të ndryshme. Për shembull, edhe pse në turqishte fonema (tingulli) **g** është bashkuar me fonemat (tingujt) **e** dhe **i**, ashtu siç shihet qartë te fjalët turke *gel* “eja” dhe *git* “shko”, ajo gjendet edhe te fjalët e tjera turke, si te: *geçmek*, “kaloj”, *gezmek*, “shëtis”, *getirmek*, “sjell”, *götürmek*, “çoj, dërgoj”, *girmek*, “hyj” që, nga pikëpamja kuptimore u jep ngjashmëri këtyre fjalëve. Edhe shkronja **g** e persishtes është zhvilluar po ashtu nga tingulli nistor **g**. Edhe tingulli (fonema) **v**, ashtu siç është ruajtur plotësisht te fjala turke *varmak* “arrij”, do të gjendet edhe te fjalët e tjera turke, si te: *vermek* “jap” dhe *vaz geçmek* “heq dorë, refuzoj”. Tingujt (fonemat) **e** (=ë-M.P.), **a** dhe **i** ruhen me kuptimet e njëjta dhe burimore në gjuhën shqipe që argumentojnë vjetërsinë e saj: rrokja **ke** (=kë – M.P.) e gjuhës shqipe, edhe pse shpreh kuptimin e fjalës turke “*şura*” që do të thotë “ai vend, ky vend”, **éa-ke** ose **ja-ke** (=eakë/ *jakë/eja(këtu)* –M.P.) do të thotë turq. “*gel*” dhe **i-ke** (=ikë/*shko* –M.P.) do të thotë turq “*git*”. Edhe **ire** e latinishtes rrjedh nga ajo fjalë. Shkronja **v** gjendet edhe te shumë fjalë (shqipe-M.P.), si: **vaté**(vajti/shkoi-M.P.), **vjen**, **ve** (=vë-M.P.), **var**. Fonema (tingulli) **v** tregon ekzistencën e saj edhe te fjalët, si: në greqishten e vjetër **veno** dhe në latinisht **venir**, me kuptimin “vij”. Tingujt **g** dhe **â** janë ruajtur plotësisht te fjala e gjuhës arabe **ğâ** (lexo: xhâ) “vij”, sepse, dihet se shkronja **xh** (**xhim**) në gjuhën arabe është barasvlerëse për shkronjën persiane **g**, domethënë për shkronjën **gamma** të greqishtes. Në gjuhën persiane sot përdoret rrokja **â** për fjalën “*gel*” të turqishtes (në shqip do të thotë “*eja*”-M.P.). Edhe tingullin **d**, që shpreh kuptimin “*jap*”, e hasim te fjalët: në persisht **dâden**, në greqisht **dhune**, **dhidho**, në latinisht **dare**, **das**; në shqip **dha**, në arabisht **i'tâ**, sepse, dihet afërsia e vendnyjetimit të shkronjave **d**, **dh**, **t**.

Shkurt, ashtu siç do të mund t'u themi "*fjalë imituese*" fjalëve që lindin vetëm nga imitimi, edhe këtij grupi të dytë të fjalëve të njohura, edhe pse disa gjuhëtarë u kanë thënë "*fjalë për marrëveshje*", mendoj se do të jetë më e qëlluar nëse quhen "*fjalë rastësie*".

Për ta shprehur qëllimin, sot përdorim lloj-lloj fjalësh; është e ditur se çdonjëren prej tyre e ndajmë në klasa të ndryshme; sipas pozicionit përdorim emër, përemër, folje, ndajfolje e të tjera dhe, është e ditur po ashtu se çdonjëres prej tyre i japim forma të ndryshme, si për shembull, formën e njëjësit, shumësit, rasës emërore, kallëzore, gjinore ose vetëm kallëzore etj.; mashkullore, femërore, veta e parë, veta e dytë, e tretë, koha e kaluar, e tashme, e ardhme, mënyra urdhërore dhe, kur këtyre do t'ua shtojmë edhe fjalët shërbyese, të folmen tonë e kemi përgatitur dhe e kemi sjellë në një gjendje të plotë dhe të sistemuar.

Të besosh se gjuha ka qenë kështu e përsosur, që kur është shfaqur për herë të parë, se të parët tanë që kanë filluar të flasin më së pari, i kanë përdorur me qindra e mijëra vjet pjesët e fjalës dhe të gjitha format e tjera të saj, se kanë mundur të flasin fjalë të lidhura dhe të sistemuara në këtë mënyrë, është sikur të përpiqesh që nga barku i nënës të lindësh njeri të përgatitur si: shkencëtar, dijetar, artist. Pasi njeriu ka lindur lakuriq dhe, pasi ka shëtitur një kohë të gjatë kështu, i ka shkuar mendja, ndoshta, të hedhë lëkurën e kafshës në shpinë dhe, pas shumë vitesh të hapë në atë lëkurë dy vrime, që t'ia vërë krahët dhe t'i japë asaj një formë të veshjes. Vetëm për këtë proces, mund të thuhet se, pa dyshim, kanë kaluar shumë shekuj. Nëse mund t'i thuhet gjuhë, pavarësisht se në ç'shkallë ka qenë, gjuhës që e kanë folur njerëzit e periudhës së katërt, atëherë, edhe lëkurës, që e kishin hedhur në shtat ata, mund t'i thuhet veshje dhe, kështu, edhe shpellave në të cilat kanë jetuar ata, pavarësisht se në çfarë shkalle kanë qenë, mund t'u thuhet shtëpi.

Një tingull që e kanë riprodhuar njerëzit e asaj periudhe, qoftë si imitim, qoftë i rastësishëm, ka qenë edhe emër, edhe mbiemër, edhe folje, edhe ndajfolje dhe, sipas nevojës, është përdorur në çdo vend. Ndërkaq, për të shprehur e për të shpjeguar llojin dhe gjendjen e tyre, gjuhës i kanë shërbyer dora, këmba dhe tërë trupi dhe, mangësitë që kanë qenë nga pikëpamja gjuhësore i kanë plotësuar me shenja. Për shembull, kur ka qenë e përshtatshme për ta shprehur kuptimin "*jap*" me tingullin **d** për të nxjerrë nga ky tingull kuptimet, si: "*jap*", "*jepet*", "*dhënie, të dhënët*", "*dhashë, kam dhënë*", "*do të japë*", "*është dhënë*", nuk e kanë parë të nevojshme e të domosdoshme në asnjë mënyrë t'i japin forma të ndryshme këtij tingulli, ose të riprodhojnë fjalë të tjera të prejardhura nga ky tingull. Ky tingull i thjeshtë, ka qenë i mjaftueshëm të shprehë çdo kuptim lidhur me këtë që do të mund t'i përgjigjet në mënyrë të pafund botës mendore a kuptimore, e po të mos ishte i mjaftueshëm, atëherë, mangësinë do ta plotësonin shenjat. Për shembull, për të thënë njeriu i atyre kohëve "*dhashë, kam dhënë*", që është veta e parë njëjës e kohës së shkuar, duke e treguar vetveten, do të thoshte "**de**". Edhe kallëzorja dhe dhanorja e kësaj foljeje është formuar, ose duke e treguar objektin me gisht, ose duke u shprehur ai (objekti) me një zë (tingull) imitues ose të rastësishëm. Sidoqoftë, kur tingulli **i** ose **b**, ka vepruar në mënyrë të veçantë për të shprehur kuptimin "*mirë, i mirë*", ky tingull, ka qenë i mjaftueshëm të shprehë kuptimin e të gjitha fjalëve të prejardhura prej saj, si: "*i mirë, mirë*", "*mirësi*", "*përmirësohem*", "*u përmirësova*", pra ka qenë edhe emër, edhe mbiemër, po edhe folje. Përemrat, meqenëse shprehen lehtë me shenja, janë

formuar shumë vonë, e sidomos, nevoja e fjalëve shërbyese (lidhëzat, parafjalët, pjesëzat, pasthirrmat) është hetuar shumë më vonë.

Pohimet tona nuk janë mbështetur vetëm në bazë të supozimit. T'i shohim dy shembuj, që do të jenë të mjaftueshëm për t'i argumentuar pohimet tona: njëri është gjuha e fëmijëve, që posa fillojnë të flasin dhe, i dyti, gjuha e primitivëve, që kanë mbetur, thuajse, në gjendjen e njerëzve të periudhës së katërt. Fëmijët që janë në moshën një a dyvjeçare, përdorin vetëm një fjalë në klasën e emrit, mbiemrit dhe foljes, ose, thënë më drejtë, përdorin vetëm ndonjë tingull dhe, fjalët shërbyese, siç e shohim nga jeta e përditshme, thuajse, nuk i përdorin dot. Edhe gjuhët që i kanë folur popujt primitivë të Australisë dhe të vendeve të tjera, kanë argumentuar se janë, pothuajse, në këtë gjendje. Këtë e kanë dëshmuar me dëshmitë e tyre ata që kanë mundur t'i studiojnë gjuhët e tyre.

Gjuha është formuar nga asgjëja, nga hiçi. Gjëja që e detyroi a e shtyu zhvillimin e saj dalëngadalë dhe shkallë-shkallë, nuk është bërë vetëm me kalimin e kohës dosidso, por, me siguri, me përparimin e kohës, është përgjithësuar dhe është zhvilluar ajo që u shfaq në mendjen e njeriut, d.m.th. gjuha. Sa më tepër që njerëzit e kthjellonin mendjen dhe trurin, aq më shumë detyroheshin të gjenin rrugë dhe mundësi për të shpjeguar akoma më shumë qëllimet e tyre; sa më shumë që shtoheshin mjetet, gjërat dhe materiet që i përdornin ose i dinin, meqë shtoheshin, natyrisht, edhe emrat e tyre, aq më tepër fillonte të zgjerohej, të përsosej e të pasurohej gjuha. Ose, po të ishte i natyrshëm përparimi i kohës dhe përparimi dhe zhvillimi i gjuhës, gjuha e primitivëve do të duhej të mbetej edhe sot e kësaj dite në atë gjendje.

Zhvillimi dhe përparimi i gjuhës, siç thamë më lart, duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin e botës njerëzore nga aspekte të ndryshme, është shfaqur për një kohë të gjatë dhe, përafërsisht, në një mënyrë të ngadalshme. Ajo, natyrisht, zhvillohet dhe përparon edhe sot e kësaj dite. Gjinia njerëzore nuk shkon përherë bashkërisht në rrugën e zhvillimit. Ajo i ngjan një karvani të madh që i lë shumë udhëtarë në shkallë të ndryshme. Edhe pse një grup njerëzish janë për të arritur në pikën që synon kjo rrugë, shumë prej tyre madje, që nga gjendja e tyre primitive e deri në gjendjen e sotme, kanë mbetur në shkallë të ndryshme. Ky është shkaku që e shohim te evropianët, të cilët kanë arritur një përparim shumë të madh të qytetërimit dhe tek eskimët e australianët, të cilët kanë mbetur në gjendjen primitive të njerëzve që nga periudha e katërt. Ka edhe popuj dhe kombe të tjerë të cilët gjenden në mes këtyre dy shkallëve. E, sa u përket rrethanave të ndryshme që ka kaluar bota njerëzore në rrugë përparimtare, që nga periudha e katërt, gjykojnë shembujt konkretë.

Edhe gjuha lidhet me këtë gjendje të përgjithshme. Kur t'i hulumtojmë e t'i studiojmë gjuhët e kombeve dhe të popujve, nga më primitivët, e deri te më të qytetëruarit, do të mund të kuptojmë gjendjen e gjuhës nëpër periudha të ndryshme dhe shkallët që kaloi ajo nëpër rrugën e zhvillimit. Në të vërtetë, kjo çështje ka mundur të ndriçohet, pasi të jenë mësuar shumë mirë gjuhët e ndryshme që fliten sot në tërë rruzullin tokësor.

Nuk është e mundur të gjesh e të dish sot gjendjen e gjuhës kur është shfaqur për herë të parë (që supozohet se është shfaqur aty nga fillimi i periudhës së katërt dhe ndoshta në periudhën e tretë), domethënë, të gjesh një gjuhë, që është sajuar nga disa zëra dhe tinguj shumë të kufizuar dhe të pacaktuar. Nuk gjendet asnjë popull në rruzullin tokësor, që ka mbetur krejtësisht në gjendjen e zanafillës së tij. Por, megjithatë, nuk ka gjuhë që do të tregojë tërësinë e shkallëve, pra të gjitha shkallët pas gjendjes së saj fillestare. Natyralisht, duke hulumtuar gjendjen e të gjitha gjuhëve që fliten, ose, që janë folur në rruzullin tokësor, duke zbuluar se te këto ka tri forma, të gjitha gjuhët, marrë në përgjithësi, i ndajnë në tri grupe.

Grupi i parë, është grupi i gjuhëve që quhen “**gjuhë njërrrokëshe**” ose **Langues monosyllabiques** ose **Langues isolantes**, *grupi i dytë* përfshin “**gjuhët përngjitëse**” ose **Langues agglutinantes** dhe, *grupi i tretë* “**gjuhët fleksibile a eptimore**” ose **Langues flexibles** ose **Langues a flexion**.

Gjuhët njërrrokëshe (izoluese a monosilabike) nuk njohin eptimin/ndryshimin e fjalëve (lakimin dhe zgjedhimin), sepse fjalët e këtyre gjuhëve janë të formuara nga tingujt njërrrokësh, që tregojnë vetëm një ndodhi, një gjë apo një gjendje, ashtu siç ka qenë në gjuhën që është shfaqur më së pari. Me pranëvënien e një, dy, a më shumë fjalëve të këtilla, ndonëse me anë të tyre formohet një fjalë pa u bashkuar dhe pa u përngjitur me njëra-tjetrën, çdonjëra prej tyre e ruan kuptimin e vet të veçantë.

Te gjuhët përngjitëse (aglutinative), që formojnë grupin e dytë ndërkaq, përsëritet e njëjta gjë; kur disa fjalë njërrrokëshe vijnë pranë njëra-tjetrës, dhe formojnë një fjalë me kuptim të caktuar, kuptimin themelor e ruan vetëm njëra nga këto fjalë, kurse të tjerat, duke i humbur kuptimet e veta themelore, i shprehin disa rrethana dhe karakteristika të tyre dhe kalojnë në pozitën a kategorinë e fjalëve shërbyese a elementeve formative të saj (të fjalës që e ka ruajtur kuptimin e saj themelor-M.P.). Çdonjëra nga rrokjet që vjen në këtë mënyrë në ndonjë pozicion, shmanget ose del nga gjendja që do të mund të konsiderohej si fjalë e mëvetësishme dhe, sado që bëhet përngjitja në mes tyre, pa u bërë bashkimi, do të vërehen qartë vendet dhe mënyrat përngjitëse. Dhe, një nga karakteristikat themelore të gjuhëve përngjitëse është fakti se, një prapashtesë fjalë-formuese dhe trajtëformuese që ndërhyt te një fjalë, ndikon dukshëm tek ajo fjalë, sepse ajo mund të tregojë një kuptim që te ndonjëra nga gjuhët fleksive do të mund të shprehet me disa fjalë. Për shembull, kuptimi i fjalës **yazdıramadım** të gjuhës turke, si gjuhë përngjitëse, në gjuhën shqipe, si gjuhë fleksive, do të mund të shprehet me një fjali të gjatë, të formuar nga nëntë fjalë, pra kuptimi i saj është “*Unë nuk kam mundur ta shtyj dikë të shkruajë*”.¹¹

Sa u përket gjuhëve fleksive, që e përbëjnë grupin e tretë të gjuhëve, te këto gjuhë, çdo fjalë që tregon një ngjarje a një gjësend, duke iu nënshtruar ndryshimit sipas kuptimit dhe përdorimit që synohet, do të marrë forma të ndryshme dhe do të lindin shumë fjalë të prejardhura. Te këto fjalë të prejardhura nuk është e mundur në asnjë mënyrë që të dallosh bashkimin dhe përngjitjen me elemente formative dhe me fjalë shërbyese të prejardhura, sepse përzihen dhe bashkohen në atë mënyrë që, në të shumtën e rasteve, është vështirë të dallosh madje lidhjen në mes fjalës së prejardhur dhe kuptimit të formuar dhe formën krijuese. Në thelb eptimi (lakimi a zgjedhimi) është çështje e posaçme në këtë gjuhë.

E, pra, a ka ekzistuar ndonjë grup i gjuhëve nga këto tri grupe gjuhësh që në fillim, që në zanafillë? Dhe, a i ka takuar ndonjë gjuhë, që nga zanafilla, një grupi që i takon tash dhe, a do t’i takojë atij grupi përgjithmonë? Dhe, të themi në fund, a e ndryshon gjuha grupin dhe, a mund të ndjekin grupet njëra-tjetrën; ose, a janë grupet gjuhësore të ndryshme ashtu siç janë të ndryshme racat njerëzore; a do të jetë e mundur që çdo grup të bartë veçoritë dhe gjendjen e tij që nga zanafilla dhe a do të mund t’i ruajë ato përherë?

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, mund të themi se mënyra dhe gjendja e këtyre tri grupeve të gjuhëve nuk vërtetohet vetëm nga aspekti hapësinor (vëndor), por edhe nga aspekti kohor. Nga aspekti hapësinor, gjuhët njërrrokëshe (monosilabike) fliten në juglindje të Azisë, gjuhët përngjitëse (aglutinative) fliten në shumë anë të Azisë Veriore dhe në Afrikë, në Amerikë e në Australi dhe, edhe gjuhët e eptueshme (fleksive) fliten në Azinë Perëndimore, në Afrikën Veriore dhe në Evropë. Nga aspekti kohor, ndërkaq, gjuhët njërrrokëshe janë shfaqur në periudhën që ka përcjellë lindjen e gjuhës, gjuhët përngjitëse në periudhën e dytë, e cila u shfaq pasi përparoi mjaft mendimi njerëzor dhe, gjuhët fleksive janë paraqitur në periudhën e tretë, që vazhdon deri në ditë tona. Pra, në etapën e parë të këtyre tri periudhave, nuk kanë ekzistuar gjuhë në rruzullin tokësor, përveç gjuhëve njërrrokëshe, në periudhën e dytë janë shfaqur gjuhët përngjitëse dhe në periudhën e tretë, gjuhët fleksive.

¹¹. Përshtatjen e këtij shembulli të turqishtes me shqipen e kam bërë unë. Samiu ndërkaq, këtë shembull të turqishtes e përshtat dhe e shpjegon me gjuhën frengje, duke e përkthyer kështu: *Je n'ai pas pu le lui faire écrire, domethënë, po ashtu me një fjali të formuar nga nëntë fjalë (M.P.).*

Në të vërtetë, s'ka dyshim se gjuhët përngjitëse kanë lindur nga gjuhët njërrrokëshe, sikundër që edhe gjuhët fleksive kanë lindur nga gjuhët përngjitëse. Mënyra dhe shkaku i këtij ndryshim shpjegohet shumë lehtë. Kështu, te një gjuhë, që konsiderohet nga gjuhët njërrrokëshe, e cila ka mbetur në gjendjen e saj burimore, konservative, disa fjalë të zhveshura nga elementet formative dhe të pandryshueshme, që janë vënë pranë njëra-tjetrës, janë përdorur në vend të fjalëve shërbyese, dhe pastaj këto fjalë janë bashkuar. Pikërisht në këtë mënyrë është shfaqur te to një lloj eptim a ndryshimi shumë i rregullt dhe i drejtë. Edhe ky ndryshim është rezultat i natyrshëm i përparimit të mendjes së njeriut. Pra, ky ndryshim, është kalimi nga gjuhët njërrrokëshe në gjendjen e gjuhëve përngjitëse. Ndërkaq, fjalët që kanë kaluar në funksion të fjalëve shërbyese a elementeve formative te gjuhët përngjitëse, duke qenë të lidhura me kalimin e kohës dhe me përparimin e mendimit njerëzor, dalëngadalë u bashkuan me fjalët bazë dhe erdhën në një gjendje që në asnjë mënyrë të mos dallohen. Fjala, duke e ndryshuar formën e saj pikërisht për shkak të këtyre bashkimeve, hyri në forma të ndryshme dhe, kështu u shfaqën fjalët e mëvetësishme, pra me kuptime të plota. Ky ndryshim ndërkaq, shkaktoi që gjuha, duke u shmangur nga gjuhët përngjitëse, të kalojë në gjendjen e gjuhëve fleksive.

Shikuar nga ky këndvështrim, këto tri forma të gjuhës, nga pikëpamja e kohës dhe e përparimit të mendjes së njeriut, janë pra, vërtet, tri shkallët e gjuhës. Duke qenë kështu, mund të themi se gjuhët njërrrokëshe, kanë qenë karakteristike për kohë të lashta, gjuhët përngjitëse, për periudhën e mesme dhe gjuhët fleksive për periudhën e tanishme, E, nëse shtrohet pyetja se, a nuk kanë qenë të nevojshme të mos ekzistojnë këto tri grupe sot? Si përgjigje e kësaj, duke e përsëritur atë që e thamë në fillim të këtij kapitulli, do të themi se, meqë raca njerëzore, marrë në përgjithësi, nuk ka përparuar menjëherë, kanë mbetur shumë popuj në shkallë të ndryshme. Përveç kësaj, është e domosdoshme të theksohet se përparimi i gjuhës nuk varet, nuk lidhet përherë me përparimin e qytetërimit, sepse ka edhe disa rrethana që, së bashku me përparimin e qytetërimit, do ta kushtëzojnë edhe ngecjen e zhvillimit të gjuhës ose, mbetjen e saj në gjendjen e mëparshme. Këto do të ndriçohen më tutje.

A janë të përbashkëta këto gjuhë në trungun e në gjinitë e tyre

Në rruzullin tokësor fliten shumë e shumë gjuhë. Të gjitha këto gjuhë, që fliten sot, a janë degëzuar nga një trung dhe nga një gjuhë e përbashkët, apo secili grup a secili nëngrup i gjuhëve është formuar dhe është shfaqur veçanërisht; a nuk ka në mes tyre ndonjë afri dhe marrëdhënie? Edhe kjo çështje është nga çështjet shumë të rëndësishme dhe shumë të vështira për t'u analizuar, ashtu si çështja e njeriut: është krijuar a nuk është krijuar nga një gjini e vetme? Kjo çështje e ka lodhur kaherë mendjen e natyralistëve. Sado që mendohet se këto dy çështje janë të lidhura për njëra tjetrën dhe se me shpjegimin dhe analizimin e njërës do të duhej shpjeguar dhe analizuar edhe tjetra, vërtet, lidhjet që janë në mes tyre, nuk janë dhe aq të shumta, sepse, po të jetë njëra nga i njëjti lloj, tjetra nuk është.

Së pari është e domosdoshme ta dimë se racat njerëzore kanë lindur nga gjini dhe brezni të ndryshme, por kjo nuk do të ndikojë fare që në mes njerëzve të mos ketë afri dhe njëjtësi gjinie. Kjo vlen edhe për gjuhët. Gjuhët që fliten sot, është e natyrshme të mos jenë të njëjta me gjuhët që janë folur qëkur është shfaqur njeriu për herë të parë, sepse ato, duke pësuar shumë e shumë ndryshime në rrjedhë të kohës, duke iu nënshtruar shumë e shumë përzierjeve, shumë prej tyre, duke u humbur e duke u bërë të paqarta, kaluan në gjuhë të tjera, kurse vendin e tyre e zunë gjuhë të tjera. Të gjitha këto ndryshime, megjithatë, nuk ndikojnë fare, që në mes gjuhëve të mos ketë një lidhje dhe një njëjtësi burimore.

E dyta, të pranuarit tonë, se racat njerëzore kanë lindur nga një gjini a nga një burim, nuk do të kërkojë dhe nuk do të ndikojë fare që, edhe gjuhët të kenë lindur nga një rrënjë a trung i përbashkët, sepse, është e mundshme që njerëzit të kenë jetuar shumë kohë pa gjuhë dhe, brenda asaj kohe, nga njëra anë, për të kërkuar jetë dhe, meqë nuk gjendej së paku dëshira dhe lidhja për të formuar një bashkësi në mes tyre, nga ana tjetër, me siguri, janë shpërndarë në drejtime të ndryshme. Dhe, kur me kohë njerëzit filluan të flasin, është e mundshme që, çdonjëri prej tyre, të ketë krijuar një gjuhë tjetër, aty ku është gjendur. Madje, edhe po të kenë filluar t'i flasin para se të shpërndaheshin, gjuhët e asaj kohe i kanë sajuar, me gjasë, nga pesë a dhjetë zëra dhe tinguj të bashkuar e pasqyruar me shenja. Nuk do të mund të supozohet e të përcaktohet se në mesin e këtyre gjuhëve, që gjendeshin në largësi disa ditëshe nga njëra-tjetra ndërkaq, të kenë formuar një njëjtësi (bashkim).

Për këtë shkak, duke mos kërkuar të analizohet çështja se, gjinia (raca) njerëzore rrjedh a nuk rrjedh nga një rrënjë e vetme, dhe, duke mos kërkuar të analizohet çështja se, rrënja e gjuhëve rrjedh a nuk rrjedh nga një rrënjë e vetme, kjo është një çështje shumë e rëndësishme, për të cilën do të duhej të bëhen përpjekje për t'u analizuar në mënyrë të veçantë.

Të vjetrit, ashtu siç kanë besuar se njerëzit i kanë takuar një lloji, një gjinie, ata, po ashtu kanë besuar edhe në të qenët e një gjuhe të përgjithshme, që është folur qëkur është shfaqur gjinia njerëzore për herë të parë. Ata madje, duke mos mundur të mendojnë se ajo gjuhë është humbur dhe se prej saj janë shfaqur dhe kanë lindur gjuhë të tjera, atë gjuhë të vjetër të përgjithshme, janë përpjekur ta gjejnë në mesin e gjuhëve ekzistuese. Shumë shkrintarë, madje në Evropë, që pas çlirimit të Stambollit e deri më tash, janë marrë me përcaktimin e gjuhës që kanë folur hz. Ademi dhe Hava. Ndonjëri prej tyre ka menduar se ata kanë folur ebraishten, ndonjëri ka menduar se ata kanë folur baskishten. Duke menduar kështu, ata dolën me shpjegime qesharake.

Sot, ndërkaq, edhe pse askush nuk beson se ndonjëra nga gjuhët ekzistuese ka qenë aq e vjetër dhe se ka mundur të flitet kur është shfaqur njeriu i parë ashtu e plotë, disa natyralistë kanë besuar se të gjitha gjuhët kanë lindur nga një gjuhë e përbashkët, nga një trung. Megjithëse është pranuar mendimi që njerëzit kanë lindur nga një gjini (lloj), ky mendim i disa natyralistëve do të konsiderohet se ka qenë krejt i kotë, në shkallë të ulët dhe të papranueshme. E kemi përmendur këtu vetëm për të ndriçuar mendimet tona të lartpërmendura.

Por, edhe natyralistët, që janë kundër këtij mendimi, e refuzojnë dhe nuk e pranojnë këtë, bile në këtë pikëpamje e teprojnë pakëz. Duke dëshiruar që të largohen e të shmangen nga ajo tepri, mendoj se ata ranë në një tepri tjetër. Shumica e natyralistëve e shihnin të domosdoshme të thonë se të gjitha gjuhët janë degë të një gjuhe të vjetër burimore dhe janë kundër atyre që pohojnë, për shembull, se ebraishtja, e cila është nga gjuhët semite, është burim i gjuhëve evropiane. Ata e kanë parë të nevojshme të pohojnë se, përveç afrisë që është në mes degëve të disa grupeve gjuhësore, ngjashmëritë e të cilave janë të qarta, në mes grupeve të ndryshme nuk ka asnjë afri dhe e shihnin të nevojshme të pohojnë se rrënjët dhe zanafillat e gjuhëve, kategoritë e të cilave janë të ndryshme, janë krejtësisht të veçanta (është fjala për gjuhët njërrrokëshe, përngjitëse dhe fleksive-M.P.).

Sidoqoftë, disa natyralistë mbështeten në orientimet e shkencave natyrore, të cilat duhet t'i marrin si shembull, por, për shkak se askush nuk do të mund të flasë kundër ndërgjegjies së vet, edhe unë, nuk do të mund të heq dorë e të mos e shpjegoj veçanërisht mendimin tim personal për këtë çështje. Meqë, janë të qarta ngjashmëritë në mes gjuhëve të ndryshme, që formojnë grupet e tyre, si për shembull gjuhët ariane, gjuhët semite dhe gjuhët turanike, askush nuk mund të mohojë afërsinë e tyre dhe se ato gjuhë janë degëzuar nga një gjuhë e përbashkët. Pastaj, si mund të gjykojmë se nuk ka asnjë afri dhe marrëdhënie në mes gjuhëve ariane dhe gjuhëve semite, ose në mes dy gjuhëve të lashta, që trugu dhe baza e secilës prej tyre është nga këto dy grupe gjuhësh? Grupi i gjuhëve ariane përfshin gjuhët iranike, gjuhët latine, gjuhët gotike, gjuhët sllave. Ai përfshin edhe disa grupe të vogla gjuhësh. Ngjashmëria në mes degëve të secilës gjuhë nga këto familje të vogla a është në shkallën e ngjashmërisë, që është në mes vetë atyre grupeve të mëdha? Për shembull, të gjithë e dallojnë ngjashmërinë që është në mes frengjishtes e italishtes, rusishtes e serbishtes, ose, gjermanishtes e finlandishtes dhe, ai që di njërën nga këto çifte, gati shumë mirë do ta kuptojë edhe tjetrën; mirëpo, për shembull, që të mund të dallosh marrëdhëniet në mes frengjishtes dhe gjermanishtes ose të italishtes dhe rusishtes, duhet të jesh gjuhëtar, filolog dhe se njohja e njërës nga këto dy gjuhë, lehtëson dhe bën të mundshme të kuptosh dhe një fjalë a fjali nga tjetra. Domethënë se të larguarit për një shkallë të afrisë, e pakëson a e zvogëlon ngjashmërinë e tyre gjithashtu për një shkallë. Kështu, afërsia që është në mes gjuhëve ariane dhe gjuhëve semite, që është e natyrshme të jetë dy a tri dhe ndoshta katër a pesë

shkallë më larg, nuk lë vend për një ngjashmëri që, natyrisht, do të mund të kuptohet lehtë. Megjithatë, po t'i kushtohet një vëmendje e duhur, do të shihet një lidhje dhe një ngjashmëri e mjaftueshme në mes këtyre dy grupeve. Fjala arabe “**xhâ**”, që e shpjeguem më lart, u pa qartë se është e një tringu të përbashkët me gjuhët ariane, po ashtu edhe fjala arabe **umm**, ka një ngjashmëri të plotë me fjalën shqipe **eme** (=ëmë, M.P.) që përdoret me të njëjtin kuptim, domethënë, me gjuhën shqipe si gjuhë ariane. Ngjashmëria e saj është në një masë të konsiderueshme edhe me fjalët në gjuhët: persiane **mam**, greke **mami** dhe në gjuhët evropiane **maman**. Edhe fjala arabe **eb** (shq. babë), shihet qartë se ka ngjashmëri me fjalët e gjuhëve ariane: në persisht **bab** dhe në gjuhët evropiane **papa**. Ngjashmëri si këto, duhet kërkuar, së paku, te fjalët që kanë qenë të shtrënguara t'i përdorin njerëzit që në krye të herës. Nuk e shohim të arsyeshme të zgjatemi më tepër me këtë rast, sado që shembujt e këtyre mund të shumëfishohen.

Meqenëse, gjuhët ariane dhe gjuhët semite i takojnë një klase, një kategorië (janë gjuhë fleksive-M.P.), në mes këtyre dy grupeve të gjuhëve, natyrisht, ka lidhje dhe marrëdhënie, bile, për këtë mund ta shtysh dikë të pranojë e të besojë, duke përdorur argumente, por është shumë vështirë t'i shtysh natyralistët e sipërpërmendur të pranojnë dhe të besojnë se ka lidhje në mes këtyre dy grupeve dhe gjuhëve turanike (si gjuhë përngjitëse –M.P.). Mirëpo, ne edhe këtu nuk shohim ndonjë pengesë. Pasi gjuhët fleksive kanë lindur nga gjuhët përngjitëse, derisa gjuhët ariane dhe gjuhët semite kanë qenë në grupin e gjuhëve përngjitëse, atëherë pse të jetë e pamundshme të jenë degë të degëzuara nga një trung me gjuhët turanike, dhe në këtë aspekt pse të jetë e pamundshme të ketë marrëdhënie në mes tyre?

Fjalët e lartpërmendura të gjuhës turke, si: *gel* “eja”, *git* “shko”, *geç* “kalo”, *gir* “hyn”, *gez* “shëtit”, si gjuhë përngjitëse nga gjuhët turanike, kanë treguar një ngjashmëri shumë të madhe me gjuhët ariane nga aspekti i mënyrës së formimit. Në këtë kuadër, edhe fjala *iyi* (shqipto *iji*) “mirë; i mirë”, shihet se tregon një ngjashmëri me fjalën greke **ev**, e cila në gjuhën e vjetër greke është shqiptuar *iji*; pastaj, fjala **ata**, shihet se tregon një ngjashmëri me fjalën që në shqip përdoret **ate** (=atë/babë – M.P.), në latinisht **atavus**.

Këtë lidhje dhe këtë ngjashmëri në mes gjuhëve dhe grupeve të gjuhëve ne nuk e lëmë vetëm me kaq, por do ta çojmë më tutje. Mund të pohojmë se ka mundësi që edhe kinezishtja, që është nga gjuhët njërrrokëshe, ka lidhje me grupet e gjuhëve të lartpërmendura, e sidomos me gjuhët ariane. Pa hyrë në mënyrë të veçantë dhe në thellësi të këtij problemi, do të kënaqemi vetëm me nja dy-tre shembuj. Dihet se fjalët “*peder*” dhe “*mader*” përdoren në mënyrë të njëjtë gati në të gjitha gjuhët ariane, kështu në greqisht përdoren në format **patir** dhe **matir**, në latinisht **pater** dhe **mater**, në gjermanisht **fater** dhe **muter**, në anglisht **father** dhe **mother**. Ashtu siç është bërë në gjuhën lituane **moter**, sinonim i fjalës **mader**, edhe në gjuhën shqipe, e njëjta fjalë (*mader*), duke e ndryshuar kuptimin, përdoret me kuptimin **motër**. Në këtë çështje ka dy gjëra që do t'u kushtojmë kujdes të veçantë: *njëra*, **a**-ja, si zanore e rrokjes së parë, ka kaluar në **o** dhe, te fjala **peder**, **p**-ja është kthyer në **f**, e *tjetra*, te të gjitha këto gjuhë, qoftë te këto dy fjalë dhe qoftë te fjalët **birader**, **dader**, **fratel**, **bruder**, që kanë lidhje me të parat, janë formuar nga rrokja **-der** ose **-ter**, të cilat janë pjesë fundore të fjalës. Prania e kësaj rrokjeje edhe te këto tri fjalë, tregon se ato janë formuar nga fjalët **pe**, **ma** dhe **bira ose fu, mu, bru** dhe **-der ose-ter**. Nuk mund ta dimë kuptimin e fjalës, që formon pjesën e dytë të strukturës (të fjalës), por, pasi te të tria fjalët është e përbashkët, janë fjalë që formojnë pjesën e parë që shprehin kuptimet themelore të “*babë*”, “*nënë*”, dhe “*vëlla*”. Dy nga këto fjalë, pra, i gjejmë në gjuhën kineze, që është gjuhë

njërrokëshe: kinezët babës i thonë **fu** dhe nënës **mu**. Edhe fjala e tretë ka ndryshuar pak, domethënë, për shkak të afërsisë së vendshqiptimit të tyre, me ndryshimin e **b**-së në **v** dhe **r**-së në **l**, e dimë që në gjuhën shqipe erdhi në formën **vela**, (=vëlla–M.P.) që ka kuptimin e fjalës *birader*.¹²

Kemi plot të drejtë të pohojmë se ekzistojnë lidhjet në mes gjuhëve të përmendura, grupet dhe nëngrupet e të cilave janë të ndryshme, sepse rrënja dhe zanafilla e gjuhëve që u përkasin këtyre tri grupeve dhe katër familjeve, janë rrëzëmalet Himalaje. Përndryshe, është e pakuptimtë madje të kërkosh marrëdhënie dhe afërsi në mes gjuhëve që fliten nga populli inka të Amerikës Jugore, nga populli hutanto të Afrikës Jugore, nga populli negrito të Australisë dhe nga populli eskimo të Polinезisë Veriut, sado që këto gjuhë janë nga gjuhët përngjitëse.

¹² Në disa të folme shqipe, kjo fjalë e gurrës persiane përdoret në formën *birazer*.

Gjuha ka jetë. Gjuha, ashtu si njeriu, lind, jeton dhe vdes. Edhe jeta e saj është si jeta e njeriut. Nëse e sheh një njeri në moshën tridhjetëvjeçare, që e ke njohur në fëmijërinë e tij dhe, një njëri në moshën gjashtëdhjetëvjeçare, që e ke njohur në moshën njëzetvjeçare, ashtu siç do të vëshesh ndryshime tek ata, sa nuk do të mund t'i njohësh, po ashtu, është provuar se edhe gjuha ndryshon aq sa, për disa shekuj nuk do të mund të kuptohet. Njeriu vetë vdes, por nganjëherë në vend të tij lë një ose më tepër pasardhës, e nganjëherë vdes pa lënë pasardhës. Kështu edhe gjuha, duke ndryshuar vazhdimisht, ajo shuhet dhe në vend të saj, nga ai ndryshim, shfaqen një ose më shumë gjuhë dhe, ndonjëherë, shuhet krejtësisht, pa lënë gjurmë. Gjuha ka një specifikë që nuk i ngjan njeriut, sepse ajo, duke i bashkuar një ose më tepër gjuhë, formon një gjuhë tjetër.

Këto ndryshime të gjuhëve nuk janë gjëra që janë shfaqur në periudha të gjata. Kanë qenë të mjaftueshëm pesë a dhjetë shekuj që të ndryshojë një gjuhë krejtësisht a të mos ekzistojë fare ose të shfaqet rishtas. Ashtu siç do të mund të gjejmë shumë e shumë shembuj të këtillë në kohë të lashta historike, po ashtu, i shohim me sytë tanë edhe ndryshimet e tyre që ndodhin ditë e për ditë. Për shembull, nëse dikush sot i thotë dy fjalë në gjuhën frenge, angleze apo gjermane të para njëmijë vjetve, kur t'i dëgjojnë ato francezi, anglezi apo gjermani, do të kujtojnë se janë kinezisht. Sipas sasanidëve, edhe gjuha *zendavesta* dhe, sipas iranianëve të sotëm, edhe gjuha *pehlevi* e sasanidëve, është e këtillë. Po t'i lexohet një greku vetëm një gjysmëvarg i Homerit, që është shkruar para tetë shekujsh, ai ose do të mohojë se Homeri ka qenë grek, ose do të refuzojë se vetë është grek.

Duke qenë se gjuha flitet në një hapësirë të gjerë, ndryshimi i natyrshëm që shfaqet me kalimin e kohës, nuk bëhet në forma dhe mënyra të njëjta në çdo anë. Meqë gjuha shfaqet në forma dhe mënyra të ndryshme, së pari ajo degëzohet në disa degë që do t'i ngjajnë njëra-tjetrës dhe, duke e mësuar njërën, do të mund të kuptohen edhe të tjerat. Këto degë, duke iu nënshtuar përherë ndryshimit në mënyra të veçanta nga njëra-tjetra, duke u shmangur nga njëra-tjetra, më në fund, çdonjëra prej tyre do të kalojë në një gjuhë të pavarur dhe derisa ajo nuk do të mësohet veçanërisht, do të mbetet në formën që nuk do të kuptohet. Dhe, edhe gjuha bazë, që ndikon të lindin këto, nëse mund të ruhet duke qenë e shkruar, do të ndryshojë nga të gjitha gjuhët që ka lindur ajo dhe do të mbetet një gjuhë e veçantë. Kjo gjendje ka ngjarë jashtëzakonisht shumë në periudhat historike. Shembulli më tipik dhe më i qartë është me gjuhën latine, sepse, janë gjuhët latine që kanë lindur nga ajo. Kur romakët e zotëruan tërë Evropën, nuk ekzistonte gjuha e etruskëve, e iberëve, e keltëve dhe gjuhë të tjera, që janë folur në anët jugore të këtij kontinenti. Në vend të tyre, kishte kaluar, si duket, latinishtja. Sado që latinishtja ishte një gjuhë e shkruar, kur qe shtrirë kaq shumë dhe kur u përzie me mbeturinat (reliktet) e gjuhëve që u humbën, duke e humbur origjinalitetin e saj të pastër, mori një formë të rëndë dhe të gabueshme. Edhe kjo formë, megjithatë, u tregua shumë e llojllojshme,

varësisht nga shtetet, për shembull, latinishtja e rëndë e Francës ishte ndryshe, ajo e Italisë ndryshe dhe ajo e Spanjës ndryshe, por, sidoqoftë, latinët i kanë kuptuar këto dhe, ata që i flisnin këto gjuhë, e kanë kuptuar latinishten. Mirëpo, me kalimin e kohës, ndryshimi bëhej gjithnjë e më i madh. Në fund, tani latinishtja ndryshoi, por edhe gjuhët latine që kishte lindur ajo, u bënë krejtësisht gjuhë më vete.

Gjendja që shihet e përfunduar te gjuhët latine, në gjuhën arabe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Dihet se gjuha arabe flitet, në mënyra të ndryshme, në të gjitha vendet, ku ajo përdoret: në Gadishullin Arabik, në Irak, në Siri, në Egjipt, në Tarabulus (Libi), në Tunis, në Algjeri, në Fas dhe në Malta. Dhe, sa dallime që ka në mes këtyre gjuhëve (dialekteve-M.P.) të ndryshme, po aq ka dallime edhe në mes arabishtes së pastër (burimore), që është gjuhë e shkruar e secilës nga këto gjuhë (dialekte). Ky dallim, megjithatë, nuk është shumë i madh, sepse ai që di sado pak njërën prej tyre, mund t'i kuptojë edhe të tjerat. Por, meqë tjetërsimet dhe ndryshimet ndodhin vazhdimisht, do të vijë një ditë që, ashtu siç nuk do të mund ta kuptojnë shamasit arabishten e egjiptasve, egjiptasit atë të algjerianëve dhe algjerianët atë të jemenasve, po ashtu këta, nuk do të mund të kuptojnë gjë edhe nga arabishtja letrare (burimore) dhe ata që e dinë arabishten burimore, nuk do të mund të kuptojnë gjë nga këto gjuhë (nga dialektet arabeM.P.). Ja pra, nëse arabishtja vazhdon kështu, do të mbesë vetëm e shkruar, ashtu si latinishtja dhe, edhe gjuha (dialekti) e Irakut, Shamit, Egjiptit, Magrebit dhe të tjerat, ashtu si gjuhët latine, do të kalojnë në gjuhë të mëvetësishme dhe të pavarura, që kanë lindur nga kjo gjuhë. Kështu, nga një gjuhë e vetme, nga një gjuhë bazë, do të lindin, sigurisht, gjashtë-shtatë gjuhë. Edhe gjuhët gjermanike dhe sllave janë formuar në këtë mënyrë. Dhe, në një kohë shumë të lashtë, në këtë mënyrë janë ndarë e degëzuar nga një gjuhë bazë edhe gjuhët ariane, edhe gjuhët semite, edhe gjuhët turanike. Është e mundshme që, në një kohë akoma më të lashtë, gjuhët bazë të këtyre tri grupeve të mëdha dhe, edhe gjuha bazë e gjuhëve njërrokëshe në anët e Kinës, të jenë ndarë nga një gjuhë bazë, që është folur në anët e Himalajeve.

Ky ndryshim dhe ky degëzim është sikur shtimi dhe shumëzimi i kafshëve dhe i njerëzve me lindje (me natalitet). Edhe pse janë shfaqur gjuhë të reja, pa mos ekzistuar sado kudo gjuhë të vjetra në këtë formë, të rejat janë formuar mbi bazën e të vjetrave dhe janë formuar nga reliktet e tyre. Sidoqoftë, ky është një përparim. Por, çdo kohë nuk është kështu, sepse, disa herë madje, gjuhët humben dhe zhduken. Qëllimi i krijimit është i nevojshëm. Të vegjlit janë thelbi, baza e jetës së të mëdhenjve dhe të dobtët janë thelbi a baza e jetës së të fuqishmëve. Dhe, shumë gjuhë janë sakrifikuar vazhdimisht për t'u përhapur gjuhët e tjera. Duke iu kthyer gjuhëve ekzistuese dhe ndryshimeve të tyre, ndonëse gjuhët që kanë lënë pasardhëse, janë shumë; gjuhët që janë zhdukur krejtësisht dhe që kanë mbetur pa gjurmë, janë më të shumta. Kur arianët u shpërngulën në vendet e Evropës, natyrisht se nuk e gjetën këtë kontinent të zbrazët, sepse, dokumentet historike të gjetura aty (zbulimet arkeologjike) kanë argumentuar se ky vend ka qenë i banuar që në periudhën e katërt. Megjithatë, nga gjuhët e atyre popujve të lashtë, kanë ekzistuar vetëm gjurmët e gjuhës baske. Gjurmët dhe emrat e popujve të tjerë janë zhdukur fare. Meqë, këto ndryshime, këto formime e mosformime s'kanë të sosur dhe, për shkak se ato dukuri vazhdojnë të rrjedhin e të ndodhin gjithnjë, ka mundësi që pas disa mijëra vitesh, ndoshta nuk do të mbetet asnjë gjuhë e tashme në rruzullin tokësor; të gjitha do t'u nënshtrohen ndryshimeve të mëdha; ndonjëra prej tyre duke u zhdukur krejtësisht dhe duke mos u njohur fare, ndonjëra, duke u shpërndarë e, ndonjëra, duke u tejetërsuar, do të ndahen në shumë gjuhë që do të jenë krejtësisht të ndryshme.

Pastaj, edhe shumë gjuhë, që sot janë të pavarura, të mëvetësishme, duke u bashkuar nga dy e nga tri, pa dyshim se do të formojnë gjuhë fare të ndryshme.

Ja pra, këtu qëndron rëndësia dhe pesha e gjuhësisë. Është kjo një gjendje, një rrethanë, që e vështirëson këtë shkencë, sepse, po të bëhen këto ndryshime në kohët historike dhe në gjuhët, letërsitë e të cilave janë shënuar e regjistruar, mësimi dhe studimi i tyre do të bëhet i lehtë. Dhe, hulumtimet që bëhen te gjuhët para kohëve historike ose te gjuhët që nuk janë të shkruara, ato janë, natyrisht, të vështira, e sidomos, kur në këto hulumtime nuk u kushtohet rëndësi ngjashmërive të jashtme dhe të rastësishme, atëherë, zbulimet e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të vërteta të tyre janë shumë të vështira.

Gjuha ka një zhvillim të përgjithshëm dhe të natyrshëm. Në këtë kuadër, gjuhët njerëzore, që janë formuar nga disa tinguj a zëra, hap pas hapi dhe shkallë-shkallë erdhën në gjendjen e gjuhëve të përsosura. Kemi shpjeguar se gjatë këtij përparimi, gjuha, sipas radhës së saj, hyri në formën e gjuhëve njërrrokëshe, gjuhëve përngjitëse dhe të gjuhëve fleksive. Kemi shpjeguar gjithashtu se, përveç shkallëshkallshmërisë së përparimit të këtyre tri formave, diç tjetër nuk ka ndodhur.

Përveç kësaj, çdo gjuhë në vete ka një përparim dhe ngecje të veçantë. Edhe kjo ndahet më dysh: njëra është e natyrshme, natyrore, e tjetra e sajuar, artificiale. Po të mos ekzistonte ngecja e përparimit të llojit (tipit) të parë, domethënë, ngecja e përparimit të përgjithshëm, nuk do të dihej dhe nuk do të kuptohej fare se ndonjë gjuhë përngjitëse të ketë lindur dhe të jetë shfaqur nga gjuhët fleksive apo, se ndonjë gjuhë njërrrokëshe të ketë lindur e të jetë shfaqur nga gjuhët përngjitëse. Mirëpo, duke ekzistuar edhe ngecja e përparimit të veçantë, kjo tregon se, një gjuhë, ashtu siç përparon, qoftë ai përparim i natyrshëm, qoftë i sajuar (artificial), ajo madje dhe stagnon (ngec prapa).

Përparimi i veçantë dhe i natyrshëm i gjuhës, si: ndarja dhe shumëfishimi i formave të eptimit/ndryshimit (lakimi dhe zgjedhimi); dallimi i gjinisë mashkullore dhe femërore; shumësia e fjalëve shërbyese, elementeve formative dhe lidhëzave të ndryshme; llojlojshmëria e fjalëve; rregullsia dhe përsosmëria e formimit të fjalisë, janë gjëra që janë shfaqur me përparimin e zgjuarsisë dhe të aftësisë së krijuar të një populli. Askush nuk mund t'i hetojë këto zhvillime. E tillë është përsosmëria e arabishtes, e greqishtes së vjetër, e latinishtes, e sanskritishtes dhe e gjuhëve të tjera të lashta të kësaj kategorie. Përparimi i arritur (i sajuar) ndërkaq, duke qenë i lidhur ngushtë me përparimin e shkencëtarit, shkencës dhe shkathtësive profesionale e teknike, është zhvillim që nxjerr në shesh termat e shpikur dhe të formuar nga shkencëtarët dhe teknologët si dhe shprehjet e krijuara e të menduara nga ana e shkrimtarëve. Pra, është rrjedhojë dhe rezultat i njeriut, e jo rredhojë dhe rezultat natyror si të tjerat. Ja pra, qëndrimi që ka njeriu për gjuhën, është i veçantë vetëm në këtë drejtim, kurse nga aspekte të tjera, njeriu lidhet ngushtë me qëndrimin dhe gjykimin e gjuhës. Këtë përparim të llojit (tipit) të dytë e shohim në formën më të plotë e më të përsosur të gjuhët ekzistuese të Evropës.

Përparimi i sajuar a artificial i gjuhës, varet gjithnjë nga përparimi material, teknik dhe mendor i popujve. Prandaj, nga kjo pikëpamje, gjuhë më e përsosur është gjuha e një populli më të qytetëruar, mirëpo, te tipi i përparimit të natyrshëm, qoftë te ai i përgjithshmi, qoftë te ai i veçanti, ka disa përjashtime dhe shihen aty kundërthënie në mes shkallës e gjendjes së popujve dhe në mes formës e gjendjes së gjuhëve. Për shembull, edhe pse s'ka farë dyshimi se kur është shfaqur përparimi gradual i zgjuarsisë dhe aftësitë natyrore (me lindje) te popujt arianë dhe semitë, në asnjërën gjuhë që e flasin sot këta (popuj), nuk shihet përsosmëria e natyrshme që ka qenë te gjuhët: gjermanishtja e vjetër, sanskritishtja, zendishtja, latinishtja, madje dhe te sllavishtja e vjetër; përkun-

drazi, shihet një prapambetje e natyrshme të këto gjuhë, që një a dy mijë vjet më parë dhe, së bashku me përparimin e arritur (artificial) ruajnë praninë e këtij përparimi të natyrshëm. Nga ana tjetër, ndonëse banorët e anëve të Kinës, Tibetit dhe Annanit, janë popuj që janë qytetëruar më së pari, gjuhët e tyre kanë mbetur deri më sot në formën e gjuhëve njërrrokëshe – që është gjuhë bazë, burimore – dhe, të cilët edhe më tutje jetojnë, thuajse si kafshët; ndërkaq, gjuhët që i flasin primitivët e Australisë, Afrikës dhe të Amerikës, që tregojnë gjurmët se kanë qenë nga njerëzit e periudhës së katërt, janë në formën e gjuhëve përngjitëse, që janë të gjendjes a radhës së dytë të gjuhës.

Nuk ka kush të mendojë e të pranojë se në Evropë ka një ngecje të zgjuarsisë dhe aftësisë së natyrshme që dy-tre mijë vjet ose, se primitivët e Australisë kanë qenë më të zgjuar dhe më të aftë se kinezët. Dhe kështu, në këtë gjendje ç'të themi për prapambetjen e natyrshme të gjuhës së evropianëve të sotëm nga latinët e dymijë vjetve më parë, ose për prapambetjen e natyrshme të gjuhës së kinezëve nga ajo e primitivëve të Australisë? Shkaqet e kësaj dukurie duhet t'i kërkojmë në rrethanat dhe në faktorët e jashtëm. Shumë e shumë herë është vënë re se rrethanat dhe faktorët e jashtëm kanë qenë pengesë në veprimin e natyrshëm.

Tani të trajtojmë arsyet e mbetjes së kinezishtes në gjendjen e gjuhëve njërrrokëshe. Për kinezët mund të thuhet se janë një popull që ka jetuar në kohë të papërshtatshme, si të thuash, në kohë pa kohë, ose që është rritur para kohe. Ashtu si një bimë që rritet para kohe ose, ashtu siç mbetet arrë, respektivisht, i pagdhundur një njeri që zhvillohet herët dhe përnjëherë, po ashtu, edhe një popull që arrin shumë herët një qytetërim, pa u krijuar kushtet paraprake, do të mbetet në nivelin e qytetërimit të asaj kohe që e ka arritur. Edhe pse është zmadhuar historia kombëtare e kinezëve, kjo gjendje e gjuhës së tyre, pikërisht tregon se duhet të mos hiperbolizohet aq shumë. Kinezët u qytetëruan që në kohën kur kanë folur me një gjuhë njërrrokëshe dhe, gjuhën e tyre kanë filluar ta shkruajnë që atëherë. Në qoftë se pra, është gjuhë që është shkruar, është shënuar dhe regjistruar që atëherë, vetvetiu kuptohet se është vështirë të kenë ndodhur ndryshime qenësore. Zaten, meqë kinezët nuk janë nga popujt që e ndryshojnë gjendjen e tyre shumë lehtë, janë përpjekur që gjuhën e tyre ta ruajnë deri më sot në atë gjendje burimore dhe konservative. Edhe shkrimi i tyre madje, duke u sistemuar sipas një gjuhe të këtyre njërrrokëshe dhe, meqë nuk është shumë i përshtatshëm për shkrimin e gjuhës që i përket një klase tjetër, ka shërbyer që gjuha e tyre të mbetet në gjendje të vjetër – të thjeshtë.

Sa i përket prapambetjes së gjuhëve ariane dhe semite, shkak i kësaj qëndron në faktin se këto gjuhë janë formuar nga bashkimi dhe afrimi i tyre me gjuhë të tjera, të cilat kanë qenë në një shkallë shumë më të ulët, ose janë formuar nga të folmet e popujve që nuk janë mësuar të flasin gjuhë aq të plotë e të përsosur. Në mesjetë, si arabishtja, si latinishtja, për shkak të shtrirjes së romakëve dhe arabëve, këto gjuhë, duke u përvetësuar nga popujt e huaj dhe, meqë ata nuk ishin mësuar të flisnin gjuhë aq të përsosur, pasi i nënçmonin imtësitë dhe barcoletat e këtyre gjuhëve të huazuara, për shkak se ishin të huaj, këto gjuhë, natyrisht, i flitnin keq dhe ato të folme të bastardhuara kishin ndikim dhe, me kalimin e kohës bëheshin rregulla. Kjo gjendje që e pamë te degët e arabishtes dhe në gjuhët latine, ka ndodhur në gjuhën persiane dhe në gjuhët indiane, shkurt, në pjesën dërrmuese të gjuhëve ariane, sepse, sado që në gjuhën zende dhe sanskrite ekzistonte gjinia mashkullore dhe femërore dhe bëhej ndryshimi i shkronjave fundore në mënyrë të rregullt, në gjuhën e sotme persiane dhe indiane, gjinia mashkullore dhe femërore kanë humbur krejtësisht gjurmët e tyre. Edhe ndryshimi i shkronjave fundore gati-gati nuk ekziston. Këto gjuhë paraqesin mangësi edhe te fjalët shërbyese, te elementet formative, e shumë e shumë të tjera.

Më pastaj, shumica e këtyre gjuhëve, duke kaluar në gjuhë letrare e shkencore, sado që arritën suksese në përparimin artificial, shkrimi dhe letërsia, jo vetëm që shërbyen në përparimin e natyrshëm të gjuhës, por, meqë u bënë shkak ta vazhdojnë e ta ruajnë gjendjen e gjuhëve të natyrshme në gjendjen e tanishme, së bashku me përparimin e tyre artificial, të sajuar, mbetën të fuqishme në ngecjen e natyrshme.

Të mos harrojmë edhe këtë: përparimi i sajuar (artificial) dhe letrar, nga aspekti gjuhësor, është shumë pak i rëndësishëm, kurse gjendja e natyrshme e gjuhëve meriton akoma më shumë peshë. Në gjuhësi nuk ka gjuhë më pak të respektuar. Për shembull, kurdishtja nuk është më pak e respektuar se persishtja, shqipja më pak se greqishtja e vjetër. Sidoqoftë, letërsia e persishtes dhe e greqishtes së vjetër, sado që shërbyen disa herë për qëllimet e gjuhëtarëve, letërsia në të shumtën e rasteve, gjendet në kundërshtim të plotë me rregullat themelore të gjuhësisë dhe, gjendja e natyrshme e gjuhës, që nuk ka hyrë në atë sistem, është akoma më e dobishme për shfrytëzim.

Thënë shkurt, përparimi i sajuar dhe letrar është shfaqur më vonë, kurse gjendja e natyrshme, është ajo bazike. Gjuhësia ndërkaq, meqë është nga shkencat natyrore, është e nevojshme që këtyre dy gjendjeve (të natyrshmes dhe të sajuarës – M.P.) t'u japë një rëndësi akoma më të madhe. Për këtë shkak, gjuhëtarët nuk e shohin asnjë gjuhë me vështrim nënçmues. Gjuhëtarët, përkundrazi, u kushtojnë vëmendje më të madhe gjuhëve, që çdokush i nënçmon, ua ul vlerën. Në këtë kuptim, gjuha jakute, një nga gjuhët e familjes së gjuhëve turanike, që e flet një popull primitiv në lumenjtë e ngrirë të Siberisë, sipas gjuhëtarëve, ashtu si turqishtja dhe maxharishtja, ka përparuar deri diku dhe është shumë më e rëndësishme se gjuhët e qytetëruara (të përziera), sepse ajo është burimore, kurse këto të qytetëruarat, janë degë.

Me zbulimin e lidhjeve dhe ngjashmërive në mes disa gjuhëve, ana më e rëndësishme dhe më e vështirë e gjuhësisë është çështja të përcaktosh se cila prej gjuhëve është burimore dhe cilat janë degë të saj. Nuk janë krijuar të gjitha gjuhët në kohët historike që, për shembull, të mund të dëshmojmë historikisht se latinishtja është bazë, kurse frengjishtja, italishtja, spanjishtja dhe disa të tjera, janë degë, që janë formuar prej saj. Shumica e gjuhëve dhe veçanërisht gjuhët e vjetra, janë formuar dhe janë shfaqur në kohë aq të lashta, sa që historia mund të ndihmojë fare pak për të caktuar rrënjët e tyre dhe për afërsitë që janë krijuar në mes tyre. Përveç formave dhe gjendjeve të këtyre gjuhëve, nuk ka diçka që do të mund të japë informacione të drejta në këtë temë, në këtë çështje. Historia më e drejtë dhe më e shëndoshë e rruzullit tokësor, ashtu siç mund të gjendet në shtresat e saj, ajo mund të gjendet edhe te vetë fjalët e gjuhës, te eptimi (lakimi dhe zgjedhimi), te rregullat si dhe te mënyra e formimit të fjalive dhe gjendje e rrethana të tjera të natyrshme.

Vetëm se, kur kërkohen ngjashmëritë dhe lidhjet në mes gjuhëve, për të mos u gabuar, ka disa rregulla, të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje.

E para, nuk duhet t'u jepet rëndësi disa fjalëve që ngjajnë rastësisht ose, që janë afër njëra-tjetrës. Derisa të mos shihet ngjashmëria dhe afërsia te disa fjalë dhe nga disa aspekte të tjera, nuk mund të gjykohet se në mes dy gjuhëve ka afërsi.

E dyta, gjuhët që nuk kanë kurrfarë marrëdhëniesh në mes tyre nga aspekti i llojit (tipologjik) dhe rrënjës (gjenetik), huazojnë vazhdimisht fjalë nga njëra-tjetra. Këto fjalë duhet shikuar dhe konsideruar huazime, e nuk duhet gjykuar se ka afërsi në mes tyre. Për shembull, ashtu si fjalët **kauçuk** dhe **kinin**, që kanë dalë madje nga pjesa qëndrore e Amerikës, e që kanë kaluar në të gjitha gjuhët, po ashtu, fjalë të këtilla në kohë të ndryshme, janë huazuar vazhdimisht në gjuhë të ndryshme nëpërmjet tregtisë dhe teknikës. Kështu, ndonëse greqishtja e vjetër është nga gjuhët ariane, në të gjejmë mjaft shumë fjalë të përbashkëta me gjuhët semite. Kjo është dëshmuar dhe argumentuar me burimet që janë marrë nga fenikasit. Lidhjet në mes fjalëve, si: **zevc**¹³ dhe **zevğos**; **ka'b**¹⁴ dhe **kibos**, janë të këtij lloji. Pastaj *deves* në greqisht i thonë **kamilos**, në latinisht **camelus**, në frengjisht **chamelle**, në gjermanisht **kameel**. Të gjitha këto fjalë janë huazuar në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën rrugë nga fjala arabe **xhemel**.

Pasi u vunë në pah fjalët e këtilla, për të mos gabuar, duhet t'i kushtohet kujdes eptimit/ndryshimit (lakimit dhe zgjedhimit), formimit të fjalisë, fjalëve shërbyese e të tjerave, më shumë se fjalëve, sepse, sado që një gjuhë merr shumë fjalë nga një gjuhë tjetër, ato asnjëherë nuk e hua-zojnë mënyrën e ndryshimit, pra të lakimit e të zgjedhimit dhe mënyrën e formimit të fjalisë. Ngjashmëria që ekziston në këtë pikëpamje,

¹³ Fjalë arabe me kuptimin "bashkëshort", "çift" (M. P.).

¹⁴ Fjalë arabe me kuptimin "kub" (M. P.).

me siguri, do të gjendet në mes gjuhëve të përbashkëta, si për nga lloji (tipologjia), si për nga rrënja (gjenealogjia). Për shembull, ndonëse më se gjysma e fjalëve, që gjenden në fondin leksikor të gjuhës angleze i përkasin latinishtes dhe afër një e katërta gjuhës së vjetër kelte dhe tashmë një e treta, gjuhës gjermane, gjuha angleze nuk është as gjuhë latine, e as gjuhë kelte. Ajo, megjithatë, hyn në grupin e gjuhëve gjermanike, sepse, ndryshimi i fjalëve të tyre (lakimi e zgjedhimi), mënyra e formimit të fjalisë, nyja shquese dhe fjalët e tjera shërbyese, janë formuar nga gjermanishtja e vjetër, domethënë, nga gjuha gotike, e cila është e afërt me gjermanishten. Edhe turqishtja ka një numër shumë të madh të fjalëve arabe dhe persiane, por, ajo nuk është as gjuhë semite, si arabishtja, e as gjuhë ariane, si persishtja. Është, pra, gjuhë e një familjeje krejt tjetër, gjuhë turanike. Persishtja e sotme, megjithëse përmban shumë fjalë arabe dhe gjuha e vjetër pehlevite, shumë fjalë asiriane, si persishtja, si pehlevishtja janë gjuhë ariane, kurse arabishtja dhe asirianishtja, gjuhë semite.

E treta, në çdo gjuhë, e veçanërisht në gjuhët e meta të popujve primitivë, gjenden shumë fjalë që burojnë nga imitimi. Meqenëse natyra a karakteri që çon në këtë imitim, është i përbashkët te të gjithë njerëzit, në mes gjuhëve që nuk kanë asfarë marrëdhëniesh, do të gjenden fjalë që përshtaten dhe përngajnë në këtë mënyrë. Për shembull, janë shumë e shumë fjalë që janë formuar me tingullin (zërin) **he he** ose **ha ha** që imiton të qeshurit me kuptimet, si: “qesh”, “zbavitem”, “gëzohem”, “disponohem”. Disa gjurmë të këtij imitimi janë të pranishme edhe në gjuhën turke (por edhe në gjuhën shqipe-M.P.). Kështu, **hi hi** ose **ii**, meqë përshkruajnë të qarët, **tu, ptu** ose **ftu**, të pështyrët, **hop** ose **hat**, të hedhurit dhe të këcyerit, fjalët e formuara nga këta tinguj (zëra), mund të jenë të ngjashëm ose të njëjtë edhe te gjuhët që nuk kanë asnjë marrëdhënie a lidhje. Nëse këto kanë ndonjë rëndësi nga aspekti gjuhësor, ajo mund të jetë në faktin se këto dëshmojnë rolin dhe shërbimin në formimin e gjuhëve të imitimit dhe të përshkrimit. Dhe, për të treguar lidhjen në mes gjuhëve, përkritazi me këtë, është e panevojshme të numërohen argumente.

E katërta, meqë gjenden disa shkallë të afrisë në mes gjuhëve, atëherë, te gjuhët, te të cilat dihet shkalla e afrisë në mes tyre, duhet kërkuar lidhja brenda kufijve dhe nevojave të kësaj shkalle dhe, tek gjuhët, te të cilat nuk dihen shkallët e afrisë, atëherë duhet kërkuar lidhja në mes tyre, varësisht nga sasia dhe cilësia e marrëdhënieve që janë midis tyre. Për shembull, ngjashmëria që është ndërmjet gjuhëve latine: frengjishtes, italishtes dhe spanjishtes, të cilat kanë lindur nga latinishtja, ose ndërmjet gjuhëve gjermanike: gjermanishtes, finlandishtes, skandinavishtes dhe anglishtes, që kanë lindur nga gjuha gotike ose të gjuhëve sllave, nuk mund ta gjejnë asnjëherë ndërmjet, për shembull, frengjishtes dhe gjermanishtes, grupet gjuhësore të të cilave janë të ndryshme, megjithëse, edhe këto, duke qenë nga gjuhët ariane, janë ndarë nga një trung. Vetëm se, meqë afrinë e tyre janë akoma larg, edhe ngjashmëritë e tyre do të jenë akoma më të pakta dhe të dobëta. Ndërkaq, lidhja që ekziston ndërmjet gjuhëve, grupet e të cilave janë të ndryshme (të veçanta), si lidhja në mes gjuhëve ariane dhe gjuhëve semite, është në shkallën sa nuk do të mund të dallohet, thujse aspak. Dhe, ndërkaq, lidhja në mes gjuhëve, grupet e të cilave janë të ndryshme, si ky grup dhe gjuhët turanike ose gjuhët kineze, janë në atë shkallë sa gjuhëtarët do të mohojnë atë (do të mohojnë se ekziston ajo lidhje). Thënë shkurt, të gjitha klasat/kategoritë të gjuhëve (gjuhët njërrrokëshe, përngjitëse dhe fleksive) janë ndarë në grupe të mëdha; shumica e këtyre grupeve janë ndarë në nëngrupe dhe nëngrupet disa herë janë ndarë në degë/çifte. Meqenëse ka shumë grupe, është e nevojshme t'i kushtohet kujdes përkufizimit a përcaktimit, se në

gjirin e cilës familje (grupi të ngushtë), cilit nëngrup, cilit grup (të madh) dhe cilës klasë/kategori i përket çdo gjuhë.

E pesta, çdo nëngrup që formon një grup të madh, ka shqiptim dhe të folme të posaçme të vetin, çdo çift (degë), që formon një nëngrup, ka shqiptim dhe të folme të posaçme ose çdo gjuhë e një çifti a dege ka shqiptim e të folme të veçantë, e madje çdo fjalë e një gjuhe shqiptohet në mënyrë të veçantë. Meqë, në të shumtën e rasteve, bashkëtingëlloret dhe zanoret ndryshojnë sipas atij shqiptimi dhe të folmeje, dhe sado që disa herë, nuk shihet asnjë ngjashmëri dhe afri nga aspekti formal në mes fjalëve që u përkasin dy gjuhëve, gjuhësia asnjëherë nuk luhetet në përcaktimin dhe përkufizimin, se të dyja gjuhët janë të njëjta, sepse dihet se në çfarë rruge kanë ndryshuar bashkëtingëlloret dhe zanoret e gjuhëve që dihen fare mirë. Për t'i kuptuar edhe lidhjet dhe marrëdhëniet e gjuhëve me gjuhë të tjera, veçoritë e të cilave nuk dihen, në këtë çështje, në radhë të parë, është e domosdoshme të përcaktohen këto veçori. Për shembull, ashtu siç e ka ndryshuar persishtja, gjuhë sanskrite nga gjuhët ariane, shkronjën **s** në **h**, edhe grekët këtë shkronjë, duke e treguar me **dhesia**, domethënë me shenjën (*), që në të shumtën e rasteve e kanë vënë mbi zanore, e shqiptonin në një mënyrë të veçantë, që, evropianët këtë e kanë ndryshuar në bashkëtingëlloren **h**. Ngjashëm me këtë, fjalët e gjuhës sanskrite, **Sind** "India" dhe **sept** "shtatë", në persishte kanë marrë formën **Hind** dhe **heft**, kurse në greqishte **epta** dhe **Indhia (India)**.

E gjashta, duhet të përcaktohet se cila nga gjuhët e dëshmuara, që kanë lidhje në mes tyre, është burimore dhe cilat janë degë, dhe duhet të përcaktohet gradualisht dallimi që është në mes tyre. Në këtë temë, disa gjuhëtarë ka herë kanë lajthitur në gabime dhe, edhe disa të tjerë iu bashkuan këtyre mendimeve të gabueshme. Hulumtuesit e kësaj shkence më në fund, duke kuptuar për stërmadhimin që iu bë kësaj çështjeje, e përmirësuan gabimin. Ashtu siç është menduar dikur për latinishten se është formuar nga greqishtja, po ashtu është besuar se trugu (rrënja) i gjuhëve ariane ka qenë gjuha sanskrite.

Megjithatë, sot, është kuptuar dhe menduar se këto tri gjuhë, së bashku me gjuhën kelte, gotike, sllave dhe ilire kanë dalë nga një trung i përbashkët dhe asnjëra prej tyre nuk ka qenë gjuhë bazë. Emri i gjuhës burimore edhe sot e kësaj dite mbetet akoma i panjohur. Në të vërtetë, meqë gjuha sanskrite është bashkëkohanike me greqishten dhe latinishten dhe, sado që ato janë tjetërsuar në një masë që, afërsitë e këtyre dy gjuhëve do të kuptohen vështirë, ajo ka mbetur gjuhë burimore, gjuhë bazë e të tjerave. Dhe, meqë nuk ka qenë menduar se nuk i nënshtrohet asnjë ndryshimi, s'ka dyshim se ajo gjuhë e lashtë burimore ka qenë një gjuhë tjetër nga gjuhët që njihen dhe, s'ka dyshim se sado të ketë dallime në mes gjuhëve ariane ekzistuese, po aq dallime ka kjo nga ato të gjitha. Dhe, po të ishte shkruar ajo gjuhë, dhe po të ekzistonin libra, ajo do vazhdonte edhe sot të mësohej, por, meqë nuk është shkruar në ato kohë, ajo, natyrisht, është zhdukur. Po të mos kishim vepra të shkruara latine ose gotike, sigurisht se do të besonim se italishtja do të ishte gjuhë burimore, gjuhë bazë e gjuhëve latine, kurse gjermanishtja, gjuhë burimore e gjuhëve gjermanike. Megjithatë, sa dallime të ketë në mes frengjishtes ose spanjishtes dhe italishtes, shohim se gjenden po aq dhe, ndoshta akoma më shumë ndryshime në mes italishtes dhe latinishtes dhe, sa dallime të ketë finlandishtja ose skandinavishtja nga gjermanishtja, shohim se edhe gjermanishtja është po aq larg nga gotishtja. Për këtë shkak, nuk mund të mos biesh në gabime, po të thuash se filan gjuha është burimore, gjuhë bazë, e filan gjuha degë.

(Gjuhët kineze, anameze, siameze, birmaneze dhe të Tibetit)

Pasi shfaqëm mendimet dhe njohuritë për gjuhën në përgjithësi, në një shkallë të mjaftueshme, nuk e shohim të parëndësishme të japim këtu njohuri të veçanta për çdonjërin nga gjuhët e ndryshme të tri grupeve të mëdha gjuhësore. E shohim të arsyeshme që në këtë trajtesë të fillojmë nga gjuhët njërrrokëshe (monosilabike), të cilat janë më të vjetrat dhe më të pastrat nga tri grupet e përmendura.

Gjuhët njërrrokëshe, ashtu si gjuhët përngjitëse, duke mos qenë të shpërndara e të përhapura në çdo anë të rruzullit tokësor, ato gjenden vetëm në një territor kompakt. Territori i Kinës, ashtu si në shumë tema të tjera, edhe në çështjen gjuhësore është në rrethana specifike dhe në kundërshtim me anët e tjera të rruzullit tokësor. Epiqendra e gjuhëve njërrrokëshe është ruajtur vetëm në pjesën e Kinës, pra, në vendet e Annamit, Sijamit, Birmanit dhe Tibetit, që në çdo pikëpamje janë të lidhura edhe sot e kësaj dite me Kinën. Meqë, u bënë të njohura veçoritë dhe rrethanat e përgjithshme të gjuhëve njërrrokëshe, kur trajtuam ndarjen e gjuhëve në tri klasa/kategori (njërrrokëshe, përngjitëse dhe fleksive), nuk e shohim të arsyeshme t'i përsërisim këtu, prandaj, do të fillojmë me radhë të japim njohuri për pesë gjuhët, që fliten në pesë vendet e lartpërmendura, që formojnë kategorinë e gjuhëve njërrrokëshe.

Kinezishtja

Gjuha kineze është ndarë në tri degë. *E para*, është gjuha e Mandarit, që vazhdon të flitet në pjesën qendrore të Kinës. *E dyta*, është gjuha e anëve të Kantonit, që është në pjesën juglindore të Kinës, kurse *e treta*, është gjuha fuxhiane, që flitet në viset veriore të pjesës së brendshme të Kinës. Edhe pse të trija këto janë degë të një gjuhe, megjithatë, kanë aq dallime, sa që banorët e pjesës jugore të Kinës, shumë vështirë do të mund ta kuptojnë gjuhën e banorëve të pjesës veriore të saj.

Në kinezishte, kuptimi që tregojnë fjalët e formuara nga një rrokje, është aq i gjerë dhe i pacaktuar, sa që në të shumtën e rasteve, kur nuk vijnë dy fjalë pranë njëra-tjetrës, nuk është e mundur të dalë ndonjë kuptim i caktuar. Për shembull, fjala **dao** jep kuptime të shumta, si: “mahnit, magjeps”, “arrij”, “mbuloj”, “flamur”, “gur”, “dërgoj”, “rrugë”; edhe fjala **lu**, edhe pse ka kuptime të shumta, si: “kthej”, “diamant”, “i papjekur”, “farkëtar”, “rrugë”, kur përdoren të dyja fjalët bashkë në formën **dao-lu**, merr kuptimin e caktuar “rrugë”. Fjalët e përdorura pranë njëra-tjetrës, nuk janë gjithnjë fjalë të këtilla sinonimike. Disa herë, kur vijnë në një vend dy fjalë, kuptimet e të cilave janë

krejtësisht të kundërta a të ndryshme, përftojnë një kuptim tjetër. Për shembull, edhe pse fjala **fu** ka kuptimin “babë” dhe **mu** “nënë”, të dyja së bashku **fu-mu**, japin kuptimin “prindër”, ose “gjysh”, ose, **juan** “larg” dhe **kin** “afër”, por të dyja së bashku **juan-kin** ka kuptimin “largësi”, ose, edhe pse **nan** ka kuptimin “mashkull” dhe **ny** “femër”, **nan-chi** do të thotë “bir, fëmijë”, **ny-chi** “vajzë”, **ny-zhin** “zonjë, grua”.

Në gjuhën kineze, siç kemi shpjeguar gjatë përshkrimit të gjuhëve njërrrokëshe, meqë nuk dallohen pjesët e fjalës, pra mjetet gramatikore, folja apo kallëzuesi, kryefjala dhe plotësi, do të kuptohen vetëm nga radhitja dhe vendi që kanë në fjali. Edhe lakimi i emrit dhe gjinia mashkullore e femërore, numri, koha e të tjera, do të kuptohen, ose nga konteksti i fjalisë ose nga disa fjalë që u shtohen atyre, për shembull, kur një fjale i shtohet një fjalë me kuptim të shumësisë, të përmbledhjes ose të shoqërimit, do të kuptohet se ajo fjalë është shumës. Fjala **nugan (nigan?)** do të tregojë të gjitha kuptimet, si: “rahat”, “rahat”, “rahatoj”, “rahatohem”, “bëj të rahatohet”, pra në një mënyrë të pacaktuar. Kështu duhet gjykuar edhe për fjalën **da**, e cila jep kuptime të papërcaktuara, si: “i madh”, “madhësi”, “rritem”, “zmadhoj”. Se cilën nga këto kuptime të përmendura do të marrë fjala, do të varet nga shumë faktorë gjuhësorë; ose nga vendi i fjalës, ose nga konteksti i fjalisë, ose nga një fjalë tjetër që i shtohet kësaj. Dijetarët kinezë, fjalëve që përdoren për të përcaktuar dhe për të përkufizuar kuptimin e një fjale tjetër të këtyllë u thonë “*fjalë boshe*” (fjalë përcaktuese a fjalë ndihmëse – M.P.) dhe, fjalëve që tregojnë kuptimin në mënyrë të papërcaktuar u thonë “*fjalë të plota*” (fjalë kryesore – M.P.). Këto “fjalë boshe”, duke marrë me kohë formën a funksionin e fjalëve shërbyese, u bënë shkak që gjuhët njërrrokëshe të kalojnë në grupin e gjuhëve përngjitëse (aglutinative).

Ashtu siç nuk ekziston shkronja **r**, në gjuhën kineze nuk gjenden dhe shkronjat **b**, **d** dhe **ajn**. Shkronja **d** gjendet vetëm në degën/gjuhën *fukan*. Shkronjat **n** ose **ng**, që shihen në të shumtën e rasteve në fund të fjalëve dhe të emrave të përveçëm të kinezishtes ndërkaq, përshkruajnë një lloj tingulli hundor që i shqiptojnë kinezët shumë fuqishëm. Të gjitha fjalët kineze fillojnë me bashkëtingëllore, prandaj, fjalët përfundojnë me zanore. Bën përjashtim këtu vetëm fjala **el** që ka kuptimin “dy” dhe “vesh,-i”. Duhet të mos harrojmë se, për ta shfaqur qëllimin a mendimin me një gjuhë që nuk i ka të qarta pjesët e fjalës, pra mjetet gramatikore dhe që nuk ka asgjë: rasat, mënyrat, gramatikën, në të shqiptuar tingullit i jepen disa mënyra shqiptimi dhe, e njëjta fjalë, duke u shqiptuar me zë të gjatë ose të shkurtër dhe, të ngadalshëm ose të lehtë, do të tregojë kuptime të ndryshme. Për këtë shkak, ndokush që e dëgjon një kinez kur flet, do të mendojë se është duke kënduar me melodi. Nëse ia adaptojmë një këngë kineze shkencës së muzikës sonë, nëse e themi sipas nevojës së kompozimit, duke e ngritur ose duke e ulur zërin, gjithsesi, do të bënim ndryshimin e kuptimit të saj.

Gjuha anameze

Kjo gjuhë, e cila flitet në anën lindore të Hint Çinit, domethënë, në Atam, Tunkun dhe Kushanshin, nuk i ngjan kinezishtes as nga aspekti i fjalëve, e as nga aspekti i bashkëtingëlloreve dhe zanoreve që përmban. Por, edhe pse është një gjuhë krejt tjetër, ajo është e përbashkët me gjuhën kineze, për arsye se, nga pikëpamja e rregullave të përgjithshme të gjuhëve njërrokëshe, edhe fjalët e kësaj gjuhe janë me nga një rrokje dhe kuptimet e fjalëve janë të papërcaktuara; sinonimet shprehen qartë kur vijnë radhazi njëra pas tjetrës; pjesët e fjalëve, rasat dhe mënyrat kuptohen nga vendi i tyre në fjali ose me shtuarjen e “fjalëve boshe”; ndryshimi kuptimor bëhet sipas shqiptimit të çdo fjale me zëra (tinguj) të ndryshëm etj. Të gjitha këto, pra, janë pika të përbashkëta të këtyre dy gjuhëve (kinezishtes dhe anamishtes – M.P.). Numri i madh i fjalëve, që ka marrë kjo gjuhë nga kinezishtja, i kanë shtyrë disa gjuhëtarë të gabojnë dhe, afria në mes këtyre dy gjuhëve ka zgjuar mendimin dhe interesimin të gjejnë një lidhje të plotë.

Gjuha siameze

Kjo gjuhë flitet në pjesët qendrore të Hint Çinit, në veri të gjirit Sijam dhe në brigjet perëndimore të tij. Akoma nuk dihet, por, me gjasë, është ndarë dhe është pavarësuar nga gjuha anameze ose nga gjuha kamboxhiane. Bashkëtingëlloret që shqiptohen në këtë gjuhë dhe, veçanërisht, **h**-ja dhe **s**-ja dhe shumë të tjera, por edhe zanoret, duke u shqiptuar me katër lloje tingujsh/zërash, e ndryshojnë kuptimin e fjalëve. Shpjegimet që i kemi bërë për çështjen e gjendjes së fjalëve, për strukturën e fjalisë dhe për mënyrën e shprehjes për gjuhën kineze, vlejnë edhe për këtë gjuhë.

Gjuha birmaneze

Kjo gjuhë flitet në pjesën jugperëndimore të Hint Çinit dhe në mes Sijamit dhe Indisë. Rrethanat e përgjithshme, emri etj., kanë bërë t’u përngjajnë tri gjuhëve njërrokëshe, të përmendura më sipër; vetëm se bashkëtingëlloret e kësaj gjuhe nuk janë të shumta e të ndryshme sa ato të gjuhës siameze. Edhe tingujt e ndryshëm, që u jepen zanoreve, nuk janë aq të shumtë.

Gjuha tibetiane

Sikurse dihet, Tibeti është një territor shumë i gjerë që gjendet në verilindje të Maleve të Himalejeve dhe në mes të pjesëve të brendshme të Kinës, Turkistanit Verior, Indisë dhe Birmanit. Ndonëse disa udhëtarë (vizitorë) pohojnë se në gjuhën që flitet në këtë vend, ekziston gjinia mashkullore, gjinia femërore, lakimi, zgjedhimi dhe rasat e emrit, marrë në përgjithësi, nuk ka dallim nga gjuhët e tjera njërrokëshe dhe është vërtetuar se shumicën e këtyre kuptimeve e shprehin, duke shtuar fjalë të veçanta, domethënë “fjalë boshe”. Dhe, pikërisht për këtë shkak, është argumentuar se është nga gjuhët njërrokëshe. Ka mendim që, Tibeti, meqë ndodhet në një territor ku bashkohen

gjuhët njërrrokëshe, gjuhët përngjitëse dhe gjuhët fleksive, edhe gjuha për të cilën po flasim, nuk është e thjeshtë, konservative sa kinezishtja. Megjithatë, gjendja e kësaj gjuhe tregon se kjo gjuhë i afrohet paksa këtij grupi të gjuhëve (gjuhëve njërrrokëshe – M.P.) dhe nuk jep mundësi të thuhet se është larg tij. Megjithëkëtë, njohuritë ekzistuese për këtë gjuhë, nuk janë në shkallën që për këtë çështje kanë guximin të japin një mendim të prerë.

Gjuha hotantuane, gjuhët bushmane, gjuhët e zezakëve, gjuhët bantu, gjuha puleane, gjuha nubiane

Kemi thënë se gjuhët përngjitëse janë shfaqur nga përparimi i gjuhëve njërrokëshe. Kjo është shkalla e dytë në rrugën e përparimit të gjuhës. Kemi përmendur se shumica e gjuhëve, që fliten në rruzullin tokësor, i përkasin kësaj klase/kategorie dhe, meqenëse në mesin e kësaj kategorie ka një numër të madh të grupeve gjuhësore, në mes tyre nuk ka asnjë lidhje dhe afri. Pasi që ia fillojmë nga poshtë ngjitimi lart, pra, duhet t'ia fillojmë nga më të ulëtat që gjenden në këtë kategori të gjuhëve (të gjuhëve përngjitëse), nga ato që janë me më shumë të meta dhe që kanë më shumë afri me gjuhët njërrokëshe.

Gjuha hotantuane

Gjuha hotantuane është gjuhë që flitet në skaj të pjesëve të Afrikës Jugore, nga një popull që është i njohur me të njëjtin emër. Nuk është ditur se prej ku ka ardhur dhe cilit grup të gjuhëve i ka takuar. Kjo gjuhë ndahet në tri degë: e para, është dega *hotante* e Gjiut të Shpresës (turq. Ümit Burnu) e cila, duke pushuar së ekzistuari që kur evropianët i okupuan ato vende, sot ajo flitet nga një popull shumë i vogël. E dyta, është dega *kura*, e cila flitet në anët veriore të Gjiut të Shpresës dhe në luginat e lumit Vaal e Modder dhe Kaledan. Edhe kjo degë e kësaj gjuhe ka pushuar së ekzistuari. E treta, ndërkaq, është dega *nama*, e cila është përhapur në anët veriperëndimore të Gjiut të Shpresës, e deri te brigjet e Oqeanit Atlantik. E flasin rreth njëzet mijë banorë. Dallimi në mes këtyre tri degëve është shumë i vogël. Ai që e di njëjërën, do të mund ta kuptojë shumë lehtë edhe tjetrën.

Kjo gjuhë është studiuar nga evropianët dhe nga rregullat e regjistruara nga ana e tyre, shihen elemente shumë të çuditshme të saj. *Së pari*, te bashkëtingëlloret dhe zanoret që kanë formuar fjalë, shihen gjëra aq të çuditshme që, ai që i dëgjon për herë të parë, nuk do ta konsiderojë zë njeriu, por do ta konsiderojë zë të një kafshe të çuditshme. *E dyta*, në fund të çdo emri, në përputhje me funksionin e tij: kryefjalë ose plotës, shtohet një fjalë shërbyese që, edhe kjo fjalë shërbyese do të ndryshojë sipas ekzistimit të fjalës: veta e parë, veta e dytë, veta e tretë dhe mashkullor, femëror, jokalimtare dhe njëjës, dysi, shumës. Këtyre fjalëve shërbyese mund t'u shtohen dhe fjalë të tjera shërbyese, të cilat tregojnë se emri do të jetë në rasën e kallëzores, dhanores, rrjedhores, instrumentalit etj. Edhe mbiemrat formohen nga emrat, duke marrë fjalë të tjera shërbyese. Foljet, ndërkaq, shfaqen me shtuarjen e fjalëve shërbyese radhazi të fjala vepruese, që tregon kryefjalën, kohën, numrin dhe rrethana të tjera. Përveç kësaj, edhe fuqia dhe mënyra e shqiptimit, që i jepet tingullit (zërit), mund të ndryshojnë kuptimet e fjalëve, ashtu siç ndodh te gjuhët njërrrokëshe.

Gjuhët bushmaneze

Bushmanët janë shumë popuj, që janë shpërndarë anembanë Afrikës Jugore. Edhe pse gjuhët që i flasin ata janë të ndryshme, gjithnjë mendohet se ato kanë raporte dhe ngjashmëri në mes tyre. Te këto gjuhë, që s'ka dyshim se janë nga gjuhët përngjitime, hetohen tinguj (zëra) akoma më të çuditshëm se në gjuhën e hotantëve. Ndonëse mendohet se kjo gjuhë ka raporte me gjuhën *hotante*, është argumentuar e dëshmuar se, megjithatë, në mes tyre nuk ka asnjë ngjashmëri por akoma nuk kanë mundur të njihen plotësisht këto gjuhë.

Gjuhët e zezakëve

Në qoftë se tërhiqet një vijë imagjinuese pikërisht nga qendra e Afrikës, për të shkuar në drejtim: njëra në perëndim dhe tjetra në jugperëndim deri në det, trekëndëshi, i formuar nga këto dy vija, që shtrihet nga lumi Senegal e deri në shtratin e lumit Kongo, do të përbëjë atdheun e zezakëve. Edhe këtë mund ta ndajmë në tri pjesë: Sudani Lindor,

Sudani Perëndimor dhe Sudani Jugor. Zezakët që janë vendosur në këto territore të gjera, mund të ndahen në disa popuj. Ende nuk ka mendim të përbashkët rreth çështjes se në ç'shikallë është lidhja dhe afria në mes gjuhëve që i flasin ata, nga njëra anë, dhe, janë a nuk janë të gjitha këto gjuhë që i përkasin një grupi. Sado që Fridrih Myleri (Friedrich Mülleri), njëri nga natyralistët e njohur, ka shpjeguar se gjuhët e zezakëve janë ndarë në njëzet e një nëndegë, këtë pohim akoma nuk e kanë dëshmuar. Sido qoftë, të gjitha këto gjuhë i përkasin grupit të madh të gjuhëve përngjitëse.

Nga të gjitha këto gjuhë, atë që më së shumti e kanë shkruar dhe regjistruar, është gjuha volofe, e cila flitet nga brigjet e lumit Senegal, e deri në thellësi të tij. Duke qenë e njohur me shumësinë dhe llojllojshmërinë e bashkëtingëlloreve dhe zanoreve, në këtë gjuhë pa pasur asnjë gjurmë të rënies së tyre në fund të fjalës dhe eptimit/ndryshimit (lakimit dhe zgjedhimit) të tyre, lakimi i emrit shprehet përmes disa përemrave, të cilët u shtohen dhe u bashkangjiten emrave. Edhe këta përemra janë të llojllojshëm, varësisht se ku gjendet lënda: afër, larg, para syve apo në mungesë të plotë. Edhe shkronjat e para ndryshojnë sipas shkronjës së fundit të fjalës. Sa u përket foljeve, ato kanë mjaft shumë mënyra foljore, vetëm se çdo mënyrë foljore formohet nga disa fjalë.

Në viset jugore të Senegambianit dhe në shumicën e viseve të Guinesë Jugore fliten gjuhët: *mandingo, bambare, susu, vai, tane, gbandi, landoro, mande, gbese, tona, mano*. Që të gjitha këto i takojnë familjes *mande*. Në ato vise ekzistojnë edhe gjuhët: *felupe, filhame, bola, sarare, papule, biafada, poxhade, бага, kalome, temane, bulome, sherbro, kisi*. Këto gjuhë i takojnë familjes së gjuhëve *felupe*. Gjendja e këtyre gjuhëve, megjithatë, nuk dihet me saktësi. Te lumi Niger në jug të Sahrasë, e edhe në juglindje të qytetit Tomboxhton flitet dhe një gjuhë e veçantë që njihet me emrin *somraj*.

Vendet, ku flitej gjuha *haoussa* ndërmjet Nigerisë dhe Bornos, përveç që kanë përhapje shumë të gjerë, ajo u bë gjuhë e përgjithshme e gjithë Sudanit dhe ka një rëndësi të madhe, në radhë të parë, nga ana tregtare e Afrikës Qendrore. Kjo gjuhë është bërë e njohur nga shënimet e Shunit, një nga misionarët anglez. Kjo gjuhë ka bashkëtingëllore të shumta dhe të llojllojshme, e sidomos zanore. Si gjuhë përngjitëse, ajo nuk bën ndryshimin e shkronjave fundore dhe ndryshime të tjera. Sado që shpreh qëllimin me anë të radhitjes së fjalëve ose me shtuarjen e fjalëve shërbyese dhe me shtuarjen e prapashtesave, ajo ka edhe gjininë gramatikore: mashkullore dhe femërore, si te përemrat, si tek emrat.

Në viset lindore të Sudanit Lindor dhe në viset e liqenit të Çadit përdoret gjuha *bornu*. Edhe kjo gjuhë ndahet në disa degë. Degët më të rëndësishme janë: *kanem, teda, kanuri, morou* dhe *nauri*. Ndonëse është një gjuhë që e dëgjojmë çdo ditë nga goja e zezakëve që jetojnë në vendin tonë (në Turqinë Osmane-M.P.), gjendja dhe rregullat e saj nuk janë shkruar. Në anët perëndimore të vendeve, ku flitet kjo gjuhë, gjenden dhe gjuhët: *musgu, botta* dhe *logone*. Që të trija këto gjuhë i përkasin një familjeje. Në viset lindore të këtyre gjuhëve dhe mu në qendër të Afrikës, flitet gjuha *bagirmi* dhe tutje saj, gjuha *maba*. Në rrafshlartën e luginës së Nilit, në anët perëndimore të Nubes dhe, edhe në anën perëndimore të Abisinisë, ndër gjuhët *zezake*, ekzistojnë dhe gjuhët: *shiluk, dinka, muer* dhe *bari*.

Në anët e gjirit të Guinesë gjenden edhe tri familje të tjera të gjuhëve: *të parën*, e përbëjnë gjuhët: *karo* dhe *garbi*; *të dytën*, e përbëjnë gjuhët: *egbe, xharuba, oxhi* dhe *akra*; *të tretën*, ndërkaq, e përbëjnë gjuhët: *ibo* dhe *nupe*.

Gjuhët bantu

Gjuhët e zezakëve janë shumë të shpërndara, por, megjithatë, kanë marrëdhënie mes tyre. Edhe Gjuhët, që fliten andej Ekuatorit të Afrikës, në jug të tij, kanë po aq lidhje në

mes tyre. Përveç gjuhës *hotantuane*, që flitet në Afrikën më jugore, të gjitha gjuhët e jugut të këtij kontinenti i takojnë një grupi të madh dhe njihen me emrin e përgjithshëm *bantu*. Meqë, nuk kanë mundur të zbulohen me saktësi vendet e kontinentit të lartpërmendur dhe, meqë ende nuk janë të njohura të gjitha gjuhët ekzistuese të këtij grupi, të gjitha gjuhët që njihen e që dihen nga brigjet perëndimore e deri te brigjet lindore dhe, që nga Ekuatori e deri në brigjet e Natalit, i përkasin këtij grupi. Meqenëse në mes këtyre gjuhëve shihet një lidhje dhe afri e qartë, edhe gjuhët që nuk njihen mund të mendohet se do t'i përkasin këtij grupi. Ky grup ndahet në tri nëngrupe: nëngrupin e parë e përbëjnë gjuhët: *zanzibar*, *zambezi* dhe *kafir e zulu*, të cilat fliten në brigjet lindore. Nëngrupin e dytë e përbëjnë gjuhët: *seçuana* dhe *tekeze*, të cilat fliten më në tahellësi të kontinentit të sipërpërmendur (të Afrikës – M.P.). Nëngrupin e tretë, ndërkaq, e përbëjnë gjuhët: *kongo*, *heru* dhe *dair*, të cilat fliten në brigjet perëndimore. Gjuhë të Zanzibarit kryesisht janë gjuhët: *kipokomo kisuaheli*, *kinika*, *kikamba* dhe *kihavou*. Në Zambez, që shtrihet në anët jugore të Zanzibarit, flitet gjuha *tete*, *sená* dhe gjuhë të tjera, kurse në Mozambik, flitet gjuha *makua*. Edhe në vendin Natal, që gjendet akoma më poshtë, drejt jugut, janë dy gjuhë që i flasin popujt *zulu* dhe *kafir*. Gjuhët e tyre janë shumë të afërta me njëra-tjetrën. Këtu bën pjesë edhe gjuha *finjo*. Njohuritë mbi gjuhën *tekeze*, që njihet nga dy gjuhët e anëve të brendisë, janë shumë të kufizuara. Gjuhën *seçuane* ndërkaq, e flet populli beçuan, në lindje, gjuhën *sesoto*, e flasin basotët; në perëndim, gjuhën *serulung* dhe *setlapi*, e flasin berulungët dhe betlapët. Të gjitha këto gjuhë dhe shumë gjuhë të tjera hyjnë në grupin e gjuhëve *bantu*. Sa u përket gjuhëve që fliten në brigjet perëndimore, këto gjuhë *bantu* të kësaj ane, nuk janë aq të shpërndara. Ato kufizohen me gjuhët *zezake* veriore në katër a pesë shkallë gjerësie gjeografike. Në anët veriore të këtyre brigjeve fliten gjuhët: *mpongve*, *dikele*, *isobo*, *doala* dhe, nga të gjitha këto, gjuhët *kongo* janë më të rëndësishmet, kurse në anët jugore të këtyre brigjeve flitet gjuha *bondo* dhe *hero*, por, edhe gjuhë të tjera.

Edhe pse janë aq të shpërndara, megjithatë, ato janë shumë të afërta me njëra-tjetrën. Përveç kësaj, këto gjuhë kanë dhe dy karakteristika që tërheqin më tepër vëmendjen e studiuesve. *E para*, ashtu si te gjuhët turanike, edhe te këto, varësisht nga bashkëtingëlloret dhe zanoret, shkaktohet rënia e bashkëtingëlloreve të fjalëve shërbyese dhe rënia e fjalëve, ku bashkohen zanoret, dhe *e dyta*, fjalët shërbyese (mjetet gramatikore) që shprehin njëjësin, shumësin, rasën, kohën e kaluar dhe rrethana të tjera, shtohen në fund të fjalëve dhe gjithnjë vijnë pas tyre. Edhe bashkëtingëlloret e këtyre gjuhëve, sado që janë shumë të llojlojshme, nuk kanë bashkëtingëllore që nuk mund të shqiptohen. Vetëm në gjuhën *zulu* dhe *kafir* gjenden disa bashkëtingëllore të çuditshme, të huazuara nga gjuha *hotantu*.

Gjuha puleane

Populli pul ose fula, duke u shpërngulur nga anët lindore të Afrikës, është përhapur në drejtim të perëndimit. Sot gjendet i shtrirë në mes lumit Çad dhe Senegambijas. Gjuha e këtyre është ndarë në disa degë. Bashkëtingëlloret dhe zanoret e saj janë të kufizuara dhe të lehta për shqiptim, përveç bashkëtingëllorev **sh** dhe **zh**, të cilat shqiptohen si grykore, ashtu si grykoret e arabishtes. Ana e çuditshme e kësaj gjuhe qëndron në faktin se në shumicën e këtyre gjuhëve, sado që për gjininë mashkullore dhe gjininë femërore kanë forma shumë të ndryshme, nuk bëhet dallimi i gjinisë mashkullore nga gjinia femërore e emrave. Vetëm se, emrat që tregojnë veten, dallohen plotësisht nga emrat që tregojnë diçka tjetër. Harmonia e bashkëtingëlloreve dhe harmonia e zanoreve, që u trajtua dhe u ndriçua te gjuhët *bantu* dhe që do të trajtohet e do të ndriçohet te gjuhët *turanike*¹⁵, në këtë gjuhë ndryshojnë akoma më tepër, varësisht nga bashkëtingëlloret dhe zanoret e fjalëve me të cilat lidhen, përkatësisht, përngjiten disa fjalë shërbyese. Në thelb, kjo është rrethana që e vështirëson këtë gjuhë. Me pranimin e Fesë islame, në gjuhën e këtij populli kanë depërtuar shumë fjalë arabe. Sado që gjuha e popullit volof dhe të popujve të tjerë zezakë, që jetojnë në perëndim të atyre vendeve, ka shumë fjalë të përbashkëta, të cilat, si duket, janë huazuar nga njëra-tjetra, megjithatë, nuk mund të mendohet se ka ndonjë afri në mes tyre.

Gjuhët nubeanë

Sado që shihet se nubeanët dhe puleanët, që sapo u përmendën, kanë prejardhje të përbashkët, në mes gjuhëve të tyre nuk shihet ndonjë lidhje. Nubeanasit flasin rreth katër gjuhë. *E para*, është gjuha burimore *nube* ose *barabra*, që flitet në anën veriore të Nubes, *e dyta*, është gjuha *dongole*, që flitet në jug të Nubes dhe që është shumë e afërt me të parën, *e treta*, është gjuha *tumale*, që flitet në jug të Kordofanit dhe, *e katërta*, është gjuha *koldaxhi*, që flitet në anën lindore të Kordofanit. Sado që mund të mendohet se gjuha *konxhare*, që flitet në disa anë të Darfurit dhe Kordofanit dhe disa gjuhë të tjera, i bashkangjiten këtij grupi, njohuritë tona për këtë nuk janë aq sa do të mund të japin ndonjë mendim të prerë.

Tekstet e prezentuara domosdoshmërisht nuk përfaqësojnë politikën e redaksisë të Dielli.net!

dielli@dielli.net

¹⁵ Sipas këtij konteksti kuptohet vetvetiu se Samiu kishte menduar të shkruajë edhe një vepër tjetër gjuhësore, sigurisht, me titullin Lisân “Gjuha”, me shënimin vëllimi 2. Megjithatë, në bazë të shënimeve dhe hulumtimeve të deritashme, një libër të tillë nuk e kemi hasur askund (M.P.).